

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7680 E hënë 15 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Nga ZËRIJETA HAJRO JAJAGA

**T**ë rinjtë në Maqedoni vazhdojnë ta shohin të ardhmen e tyre në ndonjë nga vendet e Bashkimit Europian. Cilësia e ulët e arsimit, standardi i ulët jetësor dhe papunësia... *Vijon në faqen 20*

Maqedoni, të rinjtë pa shpresë për punësim



Opinion **Ditës**

Nga Dr. VALBONA NATHANAILI

Çmimi "Nobel" në Ekonomi për vitin 2018 u nda ndërmjet studiuesve William D. Nordhaus nga Universiteti i Yale-s (ShBA) dhe Paul M. Romer nga Universiteti i New... *Vijon në faqen 21*

Një komb në rrezik



Fatos Arapi, Skifter Këllici dhe Agim Cerga gjatë një mbledhjeje  
Ekskluzive/ Raporti sekret i Plenumit XV të KQ

## Mehmeti e Fiqëretja 'kryqëzuan' poetin: Fatos Arapi s' pajtohet me realitetin tonë

Akuza e kryeministrit: Sipas Arapit, te ne s'ka lumturi, sepse s'ka drejtësi, s'ka ndjenja njerëzore

Nga DASHNOR KALOÇI

Një nga shkrimtarët që i nxori më shumë probleme regjimit komunist të para viteve '90-të dhe që i shpëtoi paq hekurave të burgut, ka qenë Fatos Arapi, i cili u ndesh që në hapat e parë të krijimtarisë së tij letrare në fillimin e viteve '60-të me diktatin e egër komunist... *Në faqen 10-11*

## FORMULA PER MASEN QE DO TE PERFITONI NE PLEQERI NE BAZE TE KONTRIBUTEVE

# PENSIONET, LLOGARITJA ME KOEFICIENTET E REJA

Shembujt konkretë për përllogaritjen. Çfarë ndodh kur dokumentacioni që dorëzoni është i pasaktë dhe masat që duhet të merrni për rivlerësim



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Në faqen 7

PADITET DHE BOÇI

"Blev 23 mijë USD këmisha", Rama i kthehet Berishës: Çdo bëj me lekët e gjyqit

Në faqen 2-3

SHQETESIMI

Ngritja e KLP në rrezik, shefja e ONM thirrje prokurorëve: Aplikoni, rol kyç!

Në faqen 4

VENDIMI I QEVERISE

Zbardhen kuotat për shpenzimet ushqimore për rreth 900 persona, mes tyre dhe fëmijë

Në faqen 6

AFATET E DOKUMENTET

Aplikimi, bursa në Itali për studentët e UT, ja degët e stadet kur mund të kandidoni

Në faqen 9

ISH-I DENUAR PER VRASJEN E MIRIT TE XHIKES



Gjykata e Apelit: Burg Lavdërim Tufës, për gjobëvënie ndaj një pronari fasonerie

Në faqen 5

Ylli Merja: Zmadhimi i mëlcisë, si ta trajtoni me bimë mjekësore

## "Ku përdoret gjembi i gomarit dhe kungulli i egër"

Kim Drasa: Kanceri i vezikës urinare dhe mënyrat e trajtimit të tij

Nga VOLTIZA DURO

Zmadhimi i mëlcisë nuk dallohet që në fillimin e saj, pasi nuk ka simptoma për një kohë të gjatë. Testi i pare mund të bëhet nga çdo individ në shtëpi e për këtë mund të preknë direkt poshtë brinjëve në pjesën e djathtë.



Nëse keni zmadhim të mëlcisë do të ndjeni një pjesë të butë që vazhdon poshtë brinjës, mund të jetë e rregullt ose e çrregullt në formë. Ndërsa një mëlç normalë nuk ndjehet menjëherë sa e preknë pjesën poshtë brinjës, pra duhet të shtypni më thellë për... *Suplement*

Suplement

# "LUFTA" E PADIVE PS-PD

Ironia e deputetit të PD: 10 mln janë hiç, unë i dhashë Alizotit 200 mijë euro!

## "Udhëtoi 25 herë me trafikantin", Balla padi për shpifje Salianjit

Deputeti i PS: Padi edhe Boçit, dëmshpërblimi për edukimin

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla ka paditur në gjykatë deputetin demokrat Ervin Salianji. Padija e Ballës vjen pas akuzave që deputeti demokrat ka lëshuar ndaj tij, lidhur me çështjen Babale, si edhe për udhëtime me charter me biznesmenin Edmond Bego. Balla kërkon 1 milionë lekë dëmshpërblim nga Salianji, si edhe njëtoji se sot do të paditet në Gjykatë edhe deputeti Luçiano Boçi, i cili përsëriti akuzat ndaj tij. Pas padisë së Ballës, reagoi edhe Salianji i cili ka zgjedhur të bëjë ironi me padinë e Ballës. Deputeti i PD-së, Ervin Salianji akuzoi Ballën se ka udhëtuar 25 herë me biznesmenin e dënuar për trafik droge në Itali, Edmond Bego. Salianji tha se shunën se nga 25 herë udhëtim të bashku, 18 herë, Balla ka udhëtuar me charter me Bego. Nga ana e tij, kreu i grupit parlamentar socialist, Balla tha se çdo shpifje e PD, opozitës apo dhe e medieve do të paditet në gjykatë. Në padinë e dorëzuar në gjykatë, thuhet se deputeti është i rënduar moralisht, dhe se kjo situatë ka ndikuar mbi familjen e tij dhe rrethin shoqëror. "Çdo shpifje të hedhur në drejtimin tonë nga aktorët e SHQUP-it, e që kazani politik e mediatic u jep zë pa asnjë verifikim edhe kur vërtetohen si të rreme, a qoftë edhe nga kazani i profileve zyrtare digjitale, ne do ta padisim në gjykatë. Të ardhurat nga çdo shpifje, për Fondin e Edukimit", shkroi Balla. "Sipas ligjit papagalli mban përgjegjësi për atë që thotë. Kështu që edhe papagalli Luçiano do të paditet nesër (sot) për shpifjen e sotme (dëshme). Ndërsa pyetja që kam për ata që e publikojnë këtë shpifje: Çfarë ju kushton të vërtetoni se numrat e fluturimeve të shpifjes në fjalë, janë avionë linje, janë fluturime zyrtare? Apo ndonjë ka merak



### Drejtoresha e Albkontrol: S'kemi të dhënat e pasagjerëve, PD të gjejë tjetër burim

Drejtoresha e Albkontrol, Belinda Balluku sqaroi dje, pas akuzave të deputetit Ervin Salianji se Albkontrol nuk disponon të dhënat e pasagjerëve. Përmes një statusi në rrjetin social, Twitter, Balluku shprehet: "Albkontrol ofron navigimin ajror në RSH. Albkontrol nuk ka disponuar ndonjëherë e as nuk disponon të dhënat e pasagjerëve, sepse ky informacion nuk është në tagrin dhe interesin e operimeve që kryejmë. Deputeti Salianji të gjejë burim tjetër për vërtetësinë e deklaratës së tij", u shpreh Balluku.



### Vasili: Ç'hall e çmendri Albkontrollin që ngatërron Ballën me Salianjin!?

Ky Taulant Balla i kërkon deputetit Ervin Salianji që t'i drejtohet Albkontrollit që të marrë informacion. Albkontrolli i partisë sqaron se nuk disponon hiç të dhëna të këtij lloji. Po pse çmendet Albkontrolli dhe nuk i drejtohet Ballës që e përmendi, por ia fusin kot fare dhe i drejtohen Salianjit që nuk e zuri fare Albkontrollin me gojë, por sistemin TIMS", shkroi dje, kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, pas reagimit të drejtoreshës së Albkontrollit.

se mos i bie audienca po nuk bëri papagallin e papagajve, duke shpërndarë "fake-news"?, tha Balla. Më tej, në ironinë e tij, pas padisë së Ballës, deputeti demokrat Ervin Salianji tha: "Unë që "i dhashë" Alizotit 200.000 euro, për Ballën 10 milionë lekë janë hiç, T? gjitha paratë që kemi të shkojnë për fondet e riedukimit, të ndihmojmë PS nga shokët e krimi-it! Sapo ka filluar! Të fala departamentit të shpifjesve!" nga ana e tij, sekretari i përgjithshëm i PS-së, Balla ishte dje, në rrethinat e zonës së tij elektorale, Librazhdit, ku së bashku me kryetarin e Bashkisë Kastriot Gurra takuan banorët të zonës. "Përmes Fondit të Edukimit që do të krijojmë me të ardhurat nga gjatë për shpifësit, do të ndërtojmë një kopsht për këtë lagje, sepse tani kemi një mundësi të artë për ta financuar. Çdo lek i fituar nga një gjyq për shpifje, do të shkojë në Fondin e Edukimit. Ky fond do të krijohet prej nesh për të mbështetur çerdhet, kopshtet, bibliotekat e shkollave, nxënësit e mirë të çdo komuniteti, me libra, kompjuterë apo materiale mësimore. Vëmendja jonë vazhdon të jetë e fokusuar tek njerëzit duke ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë për ne", u shpreh Balla.



Gjatë një seance parlamentare

### KUSH ËSHTË EDMOND BEGO

Bego ishte në qendër të debatit politik në vendin tonë, në muajin gusht. Ai u ndalua nga policia greke kur po kthehej nga pushimet e tij në Korfuz, për llogari të shtetit italian. Më 22 gusht, ai u la i lirë, pas një letre që Interpol Roma i dërgoi Interpol Athinës. Në këtë letër thuhet se Bego nuk ka asnjë dosje gjykimi në Itali dhe se nuk kërkohej nga autoritetet italiane.

### PD i kërkon sqarimet kreut të Grupit të PS

#### Boçi: Balla të thotë pse ka udhëtuar me makinën e tij me trafikantin e drogës

Deputeti i PD-së Luçiano Boçi pyeti dje, sërish publikisht kreun e grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla se çfarë e lidh me të shumëpërfolurin Edmond Bego, i dënuar në Itali për trafik droge. Në emër të PD-së Boçi tha se Balla rezulton të ketë udhëtuar 25 herë jashtë vendit me Edmond Bego, shpesh herë sipas tij me makinën e socialistit. "Partia Demokratike paraqiti fakte të reja që tregojnë lidhjen e fortë të numrit dy të Partisë Socialiste dhe kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste me trafikantin e rrezikshëm të drogës Edmond Bego, të dënuar në Itali me 21 vite burg. Taulant Balla rezulton të ketë udhëtuar jashtë vendit mbi 25 herë me trafikantin e drogës Edmond Bego, shpeshherë me të njëjtën makinë, kryesisht me automjetin e Taulant Ballës me targa AA900IN. Taulanti nga Librazhdi, gjatë historikut të udhëtimit, gjatë periudhës që qeverisë Edi Rama, ka përdorur dhjetëra herë charter-in për udhëtime jashtë Shqipërisë, ku nuk mungojnë edhe udhëtime me charter nën shoqërinë e trafikantit të drogës Edmond Bego", u shpreh Boçi. Sipas tij, Balla nuk ka dhënë ende sqarime për: "Çfarë e lidh numrin dy të Partisë Socialiste me trafikantin e drogës Edmond Bego? Pse ka udhëtuar 25 herë jashtë vendit me trafikantin e dënuar të drogës Edmond Bego? Pse ka përdorur makinën e tij personale për të udhëtuar me trafikantin ndërkombëtar të drogës Edmond Bego?". "Ata sot mund të bërtasin "shpifje", sepse nuk ka kush i heton dhe dënon. Ata mund të ndjehen sot të sigurt për kohësisht, sepse kontrollojnë gjykatat e prokurorinë. Qeveria në pakt me krimin, parlamenti i varur nga krimi, policia e drejtuar nga krimi dhe prokuroria nën urdhrat e krimi është realiteti që shih sot çdo shqiptar. Të vërtetën tonë e fshehin dot më. Lidhja e tyre me krimin e organizuar është e dokumentuar dhe fundi i tyre është i afërt", tha deputeti i PD-së.





# Kryeministri: Lekët e gjyqit do i bëjmë përparëse kopshti

## "Bleu 23 mijë dollarë këmisha", Rama-Berishës: Padi për shpifje

*Paketa Antishpifje, do të diskutohet në grupin e PS*

**K**ryeministri Edi Rama do të padisë paraardhësin e tij, Sali Berisha pas deklaratës së këtij të fundit se Rama shpenzoi 23 mijë dollarë për këmisha në Nju Jork. Kryeministri tha dje se paratë e shpifjeve do bëhen përparëse kopshti. Kryeministri Rama thotë se çdo akuzë, e cila rezulton shpifje do dënohet dhe paratë e marra do shkojnë investim për kopshte. "Sjam marrë kurrë me këtë enef digjital, po në çdo vend demokratik (+në ligjin shqiptar) çdo përhapës i shpifjes dënohet nësej si shpifës! Kjo shpifje do shkojë në gjyq. Hugo Boss im quhet Arjan, qepja si në Nju Jork çmimi si në Tiranë. Lekët e gjyqit do i bëjmë përparëse kopshti", thotë kryeministri Rama. Më herët, ish-kryeministri Sali Berisha postoi një mesazh, që sipas tij i erdhi nga "emigranti dixhital". Sipas postimit të publikuar nga Berisha, emigranti shprehet se ka lënë çdo biznes në Shqipëri dhe është larguar në Amerikë ndërsa Edi Rama ka shkuar në Nju Jork dhe ka blerë 23 mijë dollarë këmisha në Hugo Boss në **PAKETA**.



Kryeministri Edi Rama

për të mbështetur çerdhet, kopshtet, bibliotekat e shkollave, nxënësit e mirë të çdo komuniteti, me libra, kompjuterë apo materiale mësimore. Fondi i Edukimit, do të garantojë që paratë e ardhura nga gjyqet që do të bëjnë kryeministri, ministrat, deputetët, kryebashkiakët socialistë apo të tjerë

veprimtarë të forcës sonë politike të gjendur përballë një shpifjeje, të shkojnë në destinacion, mbështetur në propozimin e fituesit të gjyqit. Fondi i Edukimit do të ketë një bord drejtues, të zgjedhur me propozimin dhe miratimin e mbledhjes së zgjeruar të grupit parlamentar e qeverisë. Ky bord do të

**KAZINOTE**  
"Paratë e zeza të basteve po derdhen kazaneve për të jashtëqitur llafin se kjo u bëka që të mbetet një monopol online! Këtë për çudi s'e paska Taulanti? Mos u lodhni kot, bastet s'i shpëtoni dot më! Edhe bastet edhe ky monopol online do vdesin për Vit të Ri? Amanet dëshmitarin X", - tha dje Rama.

trajtojë propozimet e lartpërmendura dhe është e vetmja instancë që mund të vendosë tërheqjen nga një proces gjyqësor për shpifje. Në Partinë Socialiste do të ngrihet menjëherë Departamenti Antishpifje, i cili do të koordinojë dhe ndjekë ecurinë e betejës frontale ligjore kundër Shpifjes.

**FONDI I EDUKIMIT**

Sipas Ramës, çdo lek i fituar nga një gjyq për shpifje, do të shkojë në Fondin e Edukimit. Ky fond do të krijohet prej socialistëve për të mbështetur çerdhet, kopshtet, bibliotekat e shkollave, nxënësit e mirë të çdo komuniteti, me libra, kompjuterë apo materiale mësimore.

**Ndoka: Nëse Rama s'ndryshon, zgjedhjet në rrezik**

### Reforma zgjedhore, aleati i PD-së: Basha e kuptoi gabimin

**N**jë nga aleatët e Partisë Demokratike, Nard Ndoka tha se reforma zgjedhore nuk kryhet me pazare politike. Ndoka kërkoi nga Basha që të tregohet i sinqertë me partitë e koalicionit. "PD besoj që e ka kuptuar gabimin e vet, se reforma zgjedhore nuk kryhet nëpërmjet pazareve politike, nuk kryhet që dy parti politike vendosin se kush do të jetë gara për të garuar gjithë faktori politik. Kjo është një mendësi primitive e gabuar dhe ka rezultuar e dështuar për të dyja palët, një kosto jo të vogël ka edhe PD. Ndaj, shpresoj që edhe Basha do të reflektojë nën frymën e një konsensusi në radhë të parë me partitë opozitare", u shpreh Ndoka për Ora News. "Shpresoj që PD do tregohet e sinqertë me aleatët e vetë edhe nuk e ka luksin që të bëjnë përsëri manovra, çka do ta nxirrte atë të zbuluar edhe përballë aktorëve të tjerë politike por edhe në sytë e qytetarëve. Kështu që Basha e ka mision politik edhe harmonizimin e problematikës që ekziston mes partive politike opozitare duke vendosur një standard të besueshëm për gjithë politikën", tha Ndoka më tej. Kryetari i Partisë Demokratiane tha se opozita është e vendosur që të futet në zgjedhjet lokale të 2019, pasi ky është edhe misioni i saj, por nëse Rama nuk ndryshon qëndrim për kërkesat e ligjshme që opozita ka, ato rrezikohen. Ndoka tha se mazhoranca po provokon me reformën zgjedhore.



"Me këtë situatë politike, nëse nuk do ketë një kthesë të menjëhershme nga kryeministri, unë shoh një hendek të madh dhe zgjedhjet lokale janë të rrezikuara", theksoi Ndoka.

**PD publikon përgjimet për "aktorin"**

## Dokumentet për "Babalen", Alibeaj: Çfarë kishte në pakon që mori Alizoti

**D**eputeti i PD-së En Keled Alibeaj deklaroi se Fredi Alizoti, që sipas opozitës është aktori i kryeministrit Edi Rama, është blerë dhe shantazhuar nga ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj, pas akuzave për përfshirje të vëllait të tij Agron Xhafaj në pazare droge. Alibeaj publikoi disa përgjime të reja ku flitet për disa biseda telefonike po ashtu edhe për një pako që i është dhënë Alizotit, i cili akuzohet për Kallëzim të rremë. "Prej 5 muajve, Fatmir Xhafaj ka braktisur detyrën dhe është angazhuar drejtpërdrejtë në një skenar mafioz të mbrojtjes së trafikantit të drogës Agron Xhafaj. Është pikërisht skenari mafioz që njoftoi Edi Rama vetëm 2 ditë pasi u faktua që i vëllai i Ministrit të Brendshëm vazhdonte aktivitetin kriminal të trafikut të drogës, ku edhe mashtroi publikisht se kishte ek-



spertizën shkencore që provonte se ishte sagesë. Partia Demokratike ka publikuar faktet e plota që provojnë se hetimi ndaj Agron Xhafajit nuk është bërë nga Prokuroria, por nga vartësit e Fatmir Xhafajit në Policinë e Shtetit. Prokurorët vetëm kanë noterizuar çfarë i është dërguar nga vartësit e Fatmir Xhafajit", tha Alibeaj. "Sipas përgjimeve telefonike, rezultoi se: Në datën 1 Qershor 2018, ditën kur Edi Rama pretendon se aktori i tij Fredi Alizoti është vetëofruar në prokurori në orën 8 të

darkës, ai është kapur duke pohuar se ka bërë një muhabet dhe po pret të takojë Taulantin nga Librazhdi, që i ka thënë "hap gojën sa do", u shpreh Alibeaj. Biseda e publikuar nga PD, është zhvilluar më 1 qershor 2018 dhe Fredi Alizoti flet me një person të dytë, të cilit i thotë: "Dëgjo mua, dëgjo këtu ej. 5 minuta, vjen më merr Drejtori i Përgjithshëm i Fierit këtu, pesë muhabetet i ka bërë, mora një pako të mirë."

Ndërkombëtarët të shqetësuar për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, vetëm 1 prokuror kaloi vetëngulim

# Ngritja e KLP në rrezik, shefja e ONM thirrje prokurorëve: Aplikoni!

"Këshilli, rol kyç në sistemin shqiptar të drejtësisë"

Ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë duket se është në rrezik dhe kjo për shkak të mungesës së interesit nga prokurorët. Pas thirrjes së kryeprokurores Arta Marku pak ditë më parë, dje ishte shefja e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Genoveva Ruiz Calavera, e cila u kërkoi publikisht prokurorëve të aplikojnë për pozicionet vakante. Zyrtarja e lartë, nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, thotë se këshilli ka një rol kyç për avancimin e integritetit të Shqipërisë, ndaj bën thirrje që prokurorët ta shfrytëzojnë këtë moment. "Këshilli luan një rol kyç në sistemin shqiptar të drejtësisë dhe në avancimin e integritetit në BE të vendit tuaj", shkroi në Twitter, Calavera. Në 24 shtator, Prokuroria e Përgjithshme, hapi thirrjen për ven-



Shefja e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Genoveva Ruiz Calavera

det vakante në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, por me mbarimin e afatit 15 ditor asnjë kandidat nuk shprehu interes duke e dështuar procesin. Por ky afat skadoi më 10 tetor asnjë prokuror nuk aplikoi. Për të zhbllouar

ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë kryeprokuroresha ka rihapur sërish garën duke i bërë ftesë vartësve të aplikojnë për të zëvendësuar vakancën nga prokurorët e Apelit. Kjo vakancë është krijuar pasi

për shkak të vetëngulimit nga tre kandidatë nga prokurorët e apeleve vetëm një është konfirmuar në detyrë ndërsa dy të tjerët kanë "ngecur" në rrjetin e vetëngulimit. Prokuror apeli në garë për KLP ishte Bujar Hoti nga rrethi gjyqësor Durrës dhe Besa Nikhasani prokurorore Apeli nga rrethi gjyqësor Shkodër. I vetmi i konfirmuar nga prokuroria apeli që njëherazi është edhe kandidat për KLP është Arben Dollapaj nga apeli i Shkodrës. Kryeprokuroresha Marku është kujdesur që të nxisë vartësit të aplikojnë duke kërkuar po ashtu që kjo shpallje t'i dërgohet çdo prokurorë në e-mailin e tij

## DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQESIN PROKURORËT

- jetëshkrimin e përditësuar;
- deklaratat individuale të prokurorëve që i kanë mbështetur, të nënshkruara rregullisht;
- formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
- një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;
- një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;
- një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;
- informacion për të afërmit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor;
- listën e personave të lidhur, sipas kuptimit të ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike";
- Formularin e Autoritetit për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

## Ironizon deputeti i PD: Statistikat e kriminalitetit histori "suksesi"

### Xhafaj publikon shifrat: Në kohën e Bashës, më shumë krime

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj, tha dje, se qeveria i ka shpallur luftë pa kompromis grupeve kriminale, të skeduar tashmë. "Forca e Ligjit vepron e do të vazhdojë të shënojë rezultate, pa kompromis ndaj të gjitha grupeve kudo janë e çfarë janë. Shihni Tiranën, kryeqytetin tonë! E vërteta flet me shifra më shumë se me fjalë", shprehet Xhafaj.

Përmes publikimit të shifrave, Xhafaj informon se në kohën kur ishte Lulzim Basha ministër i Brendshëm, në qarkun e Tiranës, për periudhën janar-shtator 2010, numri i vrasjeve shënohte shifrën 17, ndërsa në të njëjtën periudhë të viteve 2017-2018, ky tregues është përgjysmuar duke u ulur në 8 persona. "Shpifje dhe e pavërtetë! Lulzim Basha, ish-ministri më i paafët deklaroi se: "Krimi është më i fortë se kurrë, forcat e rendit dhe organet e ligjit janë më të shpartalluara, më të dobëta se kurrë", tha ministri i Brendshëm. Shifrave



Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj

të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj iu përgjigj deputeti demokrat Gent Strazimir. Sipas Strazimirit "Rilindja" e statistikave të krimit është një histori suksesi, ashtu si kultivimi i lëndëve narkotike dhe hashashit. Sipas Strazimirit Xhafaj është i vetmi ministër i Brendshëm që e ka vëllain ende aktiv në trafikun e lëndëve narkotike dhe drogës. "Rilindja e statistikave të kriminalitetit është histori "suksesi" sa ç'është dhe është lufta kundër kul-

tivimit dhe trafikimit të drogës nën Saje qorin e Fatmirin Gonit, (të vetmin ministër të Brendshëm në Evropë që ka vëllain trafikant droge të dënuar dhe ende aktiv në "zanat")! Po zaten, ky që në "statistikë" e shënon Agronin qelibar dhe padit për shpifje ata që thonë se është në burg për trafik droge, sigurisht që "1 vrasje" do e shënojë në "statistikë", paçka se i janë vrasë 8 apo 3 njëherësh...", tha Strazimir.

zyrtar. Më herët për disa javë u bllokua edhe ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor pasi gjyqtarët e apelit refuzuan të aplikojnë ndërsa për të zhbllouar situatën disa herë reagoi edhe ambasada amerikane duke u bërë thirrje gjyqtarëve të aplikojnë. Në fund të shtatorit edhe ambasada amerikane lëshoi thirrjen për prokurorët që të aplikojnë për KLP-në.

"Shqipëria është në prag të krijimit të një sistemi drejtësisë që vërtet i shërben interesave të qytetarëve të saj. Iu bëjmë thirrje prokurorëve të ndershëm, patriotë dhe me integritet që të bëjnë përpara dhe t'i shërbejnë vendit të tyre në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Bëhuni pjesë e të ardhmes së Shqipërisë! Aplikoni këtu!", thuhet në një njoftim të ambasadës.

## PRESIDENTI META VIZITON TYRBEN E DERSHËS LUZHËS NË TROPOJË

### FOTO LAJM

Këtë fundjavë, kreu i shtetit, Ilir Meta ka zgjedhur veriun Shqipërisë. "Të vija në Tropojë, nuk mund të mos vizitoja Tyrben e Dervish Luzhës, patriotit, luftëtarit, humanistit dhe besimtarit shumë të respektuar nga tropojanët dhe të gjithë shqiptarët! Rastësi e bukur të takoja dhe dy mbesat e tij", shkroi Meta në "Facebook".



## Ngjarja në Malësinë e Madhe, si u zbulua

# Tentoi të falsifikojë një pasaportë, pranga policit

Policia në Malësinë e Madhe ka ndaluar një efektiv policie, i cili ka tentuar që të falsifikojë një pasaportë biometrike në favor të një shtetasi. Kështu sipas njoftimit të prokurorisë efektivi i policisë Faik Ujkaj është ndaluar për falsifikim në procedurat e pajisjes me pasaportë biometrike. Sipas prokurorisë komisarati i policisë Malësi e Madhe me shkresën nr. 2033 e protokolluar me 19 gusht të 2016-ës ka përcjellë në Bashkinë Koplik 12 praktika të ndryshme të personave që kanë aplikuar për t'u pajisur me pasaportë biometrike.

### NJOFTIMI I POLICISË

Efektivi i policisë Faik Ujkaj është ndaluar për falsifikim në procedurat e pajisjes me pasaportë biometrike. Sipas prokurorisë komisarati i policisë Malësi e Madhe me shkresën nr. 2033 e protokolluar me 19 gusht të 2016-ës ka përcjellë në Bashkinë Koplik 12 praktika të ndryshme të personave që kanë aplikuar për t'u pajisur me pasaportë biometrike.

detyrë ka qenë si patrullë oficeri Faik Ujka. Gjithashtu, edhe në procesverbalin e këqyrjes të regjistrit në zyrën e gjendjes civile në Koplik rezultoi se praktikat me nr 2033 të protokolluara me 19 qershor 2016, pra edhe para dy muajsh përpara se të dërgohen në komisaratin e

policisë janë dorëzuar nga i njëjti efektivi, shtetasi Faik Ujka. Prokuroria bën me dije se në atë shkresë që Ujka i ka dorëzuar Bashkisë Malësi e Madhe ka shtuar me shkrim dore emrin Admir Piranaj dhe praktikën përkatëse të këtij shtetasi. Organi i akuzës vijon më tutje duke

thënë se sipas aktit të ekspertimit përkatës ka rezultuar se emri i shtuar i Admir Piranaj si dhe shkrimet në formularin e aplikimit për pajisjen me pasaportë biometrike në emër të shtetasit Piranaj janë shkruar nga i dyshuari Faik Ujkaj. Po ashtu edhe vultat e komisarariatit të policisë Malësi e Madhe dhe nënshkrimi i shefit të komisarariatit në formularin e pajisjes me pasaportë biometrike në emër të Admir Piranaj janë të falsifikuara. Sipas prokurorisë shtetasi Faik Ujkaj është ndaluar nga policia, sepse kolegët e tij kanë ekzekutuar masën e sigurimit "arrest me burg" të vendosur nga gjykata e shkallës së parë



Foto ilustruese

në Shkodër. I gjithë ky hetim është bërë nga prokuroria e rrethit Shkodër pas afro dy vitesh hetime për këtë çështje. Kështu efektivi i policisë Faik Ujkaj akuzohet për veprat penale "shpërdorimi i detyrës dhe "falsifikim i dokumenteve" pasi ky punonjës policie në patrullë sipas prokurorisë Shkodër dysho-

het se ka falsifikuar një praktikë për pasaportë biometrike në favor të shtetasit Admir Piranaj. Prokuroria vijon hetimet për këtë rast ndërsa efektivi Faik Ujkaj tashmë do të përballë në gjykatën e shkallës së parë në Shkodër lidhur me akuzat në këtë çështje ndaj tij. **S.N.**

## Më parë ishte dënur edhe për vrasjen e Mirit të Xhikes

# Gjykata e Apelit lë në burg Lavdërim Tufën

## Akuzohet për gjobëvënie ndaj një pronari

Pasi rifitoi lirinë e par akohshme, rreth 3 vite më parë, Lavdërim Tufa u rikthye prapë në qeli. Ashtu sikurse shkalla e parë, edhe Apeli për Krime të Rënda vendosi të kyçë në qeli Tufën, ndaj të cilit rëndojnë dyshimet për akuzën e gjobëvënies në dëm të pronarit të një fasonerie. Në vendimin e gjykatës zbardhen të gjitha rrethanat e ngjarjes, provat e faktet, që mbajnë prapa hekurave ish-të dënuar për vrasjen e biznesmenit Fatmir Rama, i njohur si Miri i Xhikes. Në dokumentin zyrtar thuhet se Tufa, i vuri gjobë 90 mijë euro, administratorit të kompanisë private, që ndodhet në rrugën Siri Kodra. Në dokumentin zyrtar thuhet se i dyshuari kishte kontakte me shtetasin italian Emanuele Pinuccio, i njohur me nofkën Pino. Ky i fundit ishte në marrëdhënie biznesi me pronarin e fasonerisë, të cilit i kishte sjellë 30 makinieri. Administratori i kompanisë ka sqaruar përpara hetuesve se një pjesë e makinierive nuk ishin përdorur fare dhe se ai nuk kishte patur punë, pasi personat që kishte sjellë Pino nga Italia nuk ishin të rregullt dhe bashkëpunimi me ta ishte i pamundur. Në të tilla kushte, ai pretendon se biznesit të tij i ishte shkaktuar një dëm prej afro 100 mijë eurosh. Pavarësisht kësaj, pronari i fasonerisë këmbën-



Lavdërim Tufa gjatë seancës gjyqësore

gul se përgjatë një viti e gjysmë i ka dorëzuar italianit shumita të ndryshme parash dhe për vlerën e palikujduar, kishin rënë në marrëveshje që të kthehen mbrapsht makinieritë. Në

këtë moment, nisin problemet për të, pasi Lavdërim Tufa e kërcënonte që t'i paguante shumën prej 90 mijë eurosh, me pretendimin se ia kishte borxh italianit Pino. Për të realizuar

qëllimin e tij, ish- i dënuari kishte shkruar edhe në ambientet e jashtme të biznesit, e madje personat që e shohëronin kishin goditur një nga rojet. Pas arrestimit të Tufës, në kërkim u shpall

italiani Emanuele Pinuccio dhe një person tjetër. I përfshirë në këtë histori, është edhe një polic i burgeve, lidhje shoqërore e Tufës, i cili po hetohet në gjendje të lirë për moskollëzim krimi.

### VENDIMI

Në vendimin e gjykatës zbardhen të gjitha rrethanat e ngjarjes, provat e faktet, që mbajnë prapa hekurave ish-të dënuar për vrasjen e biznesmenit Fatmir Rama, i njohur si Miri i Xhikes.

### PEQIN/TIRANE

#### Kontrolle në burgje, kanabis dhe telefona në qelitë e të dënuarve

Rastet kur brenda qelive zbulohen sende të jashtëligjshme, nuk janë të panjohura në burgjet e vendit tonë. Kështu në sajë të kontrolleve të ushtruara dje në disa institucione të vuajtjes së dënimit, në një qeli në burgun e Peqinit, në dhomën e të dënuarit me inicialet A.D., u gjet një sasi kanabisi. Burime nga Ministria e Drejtësisë bënë me dije se këtij shtetasi iu gjetën 3 doza me kanabis, të cilat thuhet se i shpërndante në burg. Një tjetër kontroll është kryer në burgun e Vaqarit, pas informacioneve se të paraburgosurit D.R. dhe S.K. mbanin një telefon celular. Nga kontrolli i dhomës së tyre u konstatua i fshehur në njërin nga krevatet një aparat celular model iPhone. I paraburgosuri S.K., i cili ishte dhe prezent gjatë kontrollit pranoi autorësinë e këtij celulari. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje do të intensifikojë punën operative për zbulimin dhe kapjen e sendeve të ndalura në burgje në funksion të forcimit të sigurisë së brendshme në këto institucione.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPERFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META.

ÇMIMI 3.850.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë **09.11.2018** .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

**EPSA** SHOQËRIA PËRMBARIMORE PRIVATE "E.P.S.A"

SHPK NJOFTON SHPALLJE E ANKANDIT PER :

1- "**Ndërtesë 3 Kat**", pa truall, me vetem Kati i Pare i regjistruar ne ZVRRP Tiranë me sip. 131 m² dhe Kati i Dytë dhe Kati i Tretë ndertim pa leje, i ndodhur ne Rr "Siri Kodra", Tiranë, Zona Kadastrale: 8340, Numri i Pasurisë: 4/171-ND, Vol.9, Faqe 127. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te **Fethi Kaya**. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **12.320.000 Leke** . Ankandi zhvillohet datë **23.10.2018 ora 16.00** në adresen Rr: "I. Qemali", Pall. "Fratar", K.6, Tiranë.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne [www.epsa.al](http://www.epsa.al)

**3H** SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k

Rr. "Fisat Dëshia", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë  
Web: [www.3h.al](http://www.3h.al); Email: [shpgj.3h@yohoo.com](mailto:shpgj.3h@yohoo.com); cel: 0692099711

Njofton shpalljen e ankandit nga **dt.11.10.2018 deri ne dt. 19.10.2018** per: sendin e luajtshem mjeti me targe AA 089 OB ne pronesi te Subjektit Naber Konfeksion Shijak shpk me NIPT J62208504M

Çmimi fillestar eshte 993 EURO

Ankandi zhvillohet ne zyrën permbarimore ne daten **19.10.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.**

# QENDRAT REZIDENCIALE

## UDHEZIMI

Fletorja Zyrtare/ Sa është përcaktuar shuma për jetimet dhe shtëpitë e të moshuarve

# Vendimi, zbardhen kuotat për shpenzimet ushqimore për rreth 900 persona

Përfitojnë 205 fëmijë dhe 285 të moshuar në qendrat rezidenciale

Voltiza Duro

Janë përcaktuar kuotat financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për të gjithë të moshuarit dhe fëmijët që marrin shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot vendimin e plotë të ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu si dhe tabelat përkatëse mbi numrin e përfutuesve, ditët e qëndrimit të tyre në këto qendra dhe kuotën ditore të përmirësuar. Aktualisht nga ky vendim preken rreth 900 persona, ndër të cilët 285 të moshuar dhe 205 fëmijë të moshës 0-15 vjeç. "Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, është: Për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve, në 360 lekë; për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 0-3 vjeç, të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 360 lekë", theksohet në udhëzim. Në këtë të fundit bëhet me dije se për fëmijët e grup-moshës 4-5 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, kuota ditore për ushqimet është 400 lekë ndërsa për fëmijët e grup-moshës 6-12 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, është 440 lekë. "Për fëmijët e grup-moshës 13-15 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 480 lekë. Për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 500 lekë. Për përfutuesit mbi moshën 18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 520 lekë. Për përfutuesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës 7-11 vjeç, në 400 lekë. Për përfutuesit e vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 500 lekë. Për përfutuesit mbi moshën 18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 520 lekë. Për përfutuesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës 7-11 vjeç nga 340 lekë, në 380 lekë për përfutuesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës mbi 11 vjeç nga 340 lekë, në 500 lekë në qendrat ditore polivalente nga 160 lekë, në 220 lekë në qendrat ditore të zhvillimit nga 220 lekë, në 320 lekë në shtëpinë e fëmijës 6-18 vjeç nga 220 lekë, në 320 lekë



Foto ilustruese



FËMIJËT 4-5 VJEÇ

## Kuotat

Për fëmijët e grup-moshës 4-5 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, kuota ditore për ushqimet është 400 lekë ndërsa për fëmijët e grup-moshës 6-12 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, është 440 lekë.

### UDHËZIMI

"Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, është: Për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve, në 360 lekë; për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 0-3 vjeç, të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 360 lekë", theksohet në udhëzim.

barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim, për kategoritë e përfutuesve të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi. Efektet financiare të përballimit për shpenzimet e ushqimit nga rritja e nivelit të kuotës financiare të shpenzimeve për ushqim, përballohen nga fondet e buxhetit qendror; të programuara për shërbimet e përkujdesjes shoqërore. Udhëzimi Nr. 689, datë 2.10.2018 për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore ka hyrë në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe e shtrirë efektin financiar nga data 1.10.2018.

Tabela për indeksimin e shpenzimeve për kuotën ushqimore	Kuota e miratuar në 2012	Inflacioni			Ndryshimet në vite Cmimi kusumit						
		2010	2011	2017	2010	2011	2017	Llogaritja	Propozimi	Rritja	%
		3	2.9	3.2	15.5	16.9	7.3	sipas grupeve			
për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve nga 300 lekë në 360 lekë	300	9	9.0	10	48	60	31	467.5	360.0	60	17
për foshnjat e grup-moshës 0-3 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 300 lekë, në 360 lekë	300	9	9.6	10	10	54	28	420.1	360.0	60	17
për foshnjat e grup-moshës 4-5 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 310 lekë, në 400 lekë	310	9.3	9.9	11	10	56	29	434.1	400.0	90	23
për fëmijët e grup-moshës 6-12 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 330 lekë, në 440 lekë	330	9.9	10.5	11	11	59	31	462.1	440.0	110	25
për fëmijët e grup-moshës 13-15 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 340 lekë, në 480 lekë	340	10.2	10.9	12	11	61	32	476.1	480.0	140	29
për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 340 lekë, në 500 lekë	340	10.2	10.9	12	11	61	32	476.1	500.0	160	32
për përfutuesit mbi moshën 18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 340 në 520 lekë	340	10.2	10.9	12	11	61	32	476.1	520.0	180	35
për përfutuesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës 7-11 vjeç nga 340 lekë, në 380 lekë	340	10.2	10.9	12	11	61	32	476.1	400.0	60	15
për përfutuesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës mbi 11 vjeç nga 340 lekë, në 500 lekë	340	10.2	10.9	12	11	61	32	476.1	500.0	160	32
në qendrat ditore polivalente nga 160 lekë, në 220 lekë	160	4.8	4.8	5	26	34	17	251.6	230.0	70	30
në qendrat ditore të zhvillimit nga 220 lekë, në 320 lekë	220	6.6	6.6	7	35	47	24	345.9	320.0	100	31
në shtëpinë e fëmijës 6-18 vjeç nga 220 lekë, në 320 lekë	220	6.6	6.6	7	35	47	24	345.9	320.0	100	31

Efektet financiare të përmirësuar	Propozuar	Rritja	Nr klienteve	Dite qëndrimi	Efektet financiar
për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve nga 300 lekë në 360 lekë	360	60	285	365	6,241,500
për foshnjat e grup-moshës 0-3 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 300 lekë, në 360 lekë	360	60	20	365	438,000
për foshnjat e grup-moshës 4-5 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 310 lekë, në 400 lekë	400	90	93	365	3,055,050
për fëmijët e grup-moshës 6-12 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 330 lekë, në 440 lekë	440	110	12	365	481,800
për fëmijët e grup-moshës 13-15 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 340 lekë, në 480 lekë	480	140	80	365	4,088,000
për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 340 lekë, në 500 lekë	500	160		365	-
për përfutuesit mbi moshën 18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesit nga 340 në 520 lekë	520	180	32	365	2,102,400
për përfutuesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës 7-11 vjeç nga 340 lekë, në 380 lekë	400	180	12	365	788,400
për përfutuesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës mbi 11 vjeç nga 340 lekë, në 500 lekë	500	140	177	365	9,044,700
në qendrat ditore polivalente nga 160 lekë, në 220 lekë	230.0	70	74	260	1,346,800
në qendrat ditore të zhvillimit nga 220 lekë, në 320 lekë	320.0	100	96	260	2,496,000
në shtëpinë e fëmijës 6-18 vjeç nga 220 lekë, në 320 lekë	320.0	100	14	260	364,000
<b>Efektet financiar ne Total</b>					<b>30,446,650</b>

# LLOGARITJA E PENSIONEVE SHEMBUJT KONKRETË

Çfarë ndodh kur dokumentacioni që dorëzoni është i pasaktë, masat që merren

Voltiza Duro

**P**ara disa ditësh, në Fletoren Zyrtare janë publikuar koeficientet e reja të indeksimit të pagave për vitin 2018, e në bazë të tyre do të përllogariten pensionet për të moshuarit. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot shembuj konkretë si dhe formulën e saktë sipas së cilës pensionistët mund të verifikojnë se sa është masa e pagesës që do iu takojë për të gjitha vitet që ata kanë punuar me kontribute. Kështu ky vendim i Këshillit të Ministrave, i propozuar fillimisht nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë prek të gjithë pensionistët e dalë në pension nga 1 janari i vitit 2018 e në vazhdim. Ndërkohë Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bëjë rlllogaritjen e masës së pensioneve për të moshuarit që aktualisht kanë dalë në pension, por që iu janë llogaritur masat me koeficientë më të ulët. Kështu pensionet që janë lidhur e që do të lidhen në vazhdim do të shumëzohen me koeficientin 8,76. Në vitin 2018, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2017, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë të përcaktuar në këtë vendim nuk mund të jenë më të larta se trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim. "Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2018 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore", nënvizohet në vendimin e qeverisë.

**KOEFICIENTET**

"Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, paragrafi i dytë, e 59, pika 1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

# Si të përllogarisni saktë pensionet e pleqërisë me koeficientet e reja të 2018-ës

Formula, sa do të merrni në bazë të viteve të punës kontributive

**DOKUMENTACION I PASAKTË**

Librezat e punës mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vullsh apo dublikatë librezat. Punonjësit e ISSH-së duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listpagesat që të vërtetojnë faktin që individit ka qenë realisht në marrëdhënie pune.



**RILLOGARITJA**

Ky vendim i Këshillit të Ministrave prek të gjithë pensionistët e dalë në pension nga 1 janari i vitit 2018 e në vazhdim. Ndërkohë Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bëjë rlllogaritjen e masës së pensioneve për të moshuarit që aktualisht kanë dalë në pension por që iu janë llogaritur masat me koeficientë më të ulët.

që koeficientët e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve, me datë fillimi 1.1.2018 dhe në vazhdim, sipas viteve, të jenë si në tabelë", -theksohet në vendim. Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 927, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë fillimi deri më 31.12.2017, përfshirë edhe këtë datë. Koeficientet e indeksimit janë ata koeficientë që kërkohen që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra ti heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indeksat e ndryshimit që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indekskohet sot me një koeficient. Edhe ky indeks sot është i përshtatshëm, e fillojnë nga 94' deri në Përllogaritja

sipas formulës'

Pasi bëhet indeksimi, sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicionin pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indekskohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individit i del një pagë mesatare bazë e vlerësueshme, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë së cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del një vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni. Kjo është mënyra më e thjeshtë për llogaritjen e pensionit.

**DOKUMENTACIONI**

Individi që mendon se mund të përfitojë pension pleqërie duhet të bazohet në kriteret, moshën dhe vitet me kontribute. Domosdoshmërisht duhet të ketë dokumentin që vërteton moshën, e cila duhet të jetë mbi 60 vjeç e 8 muaj për gratë e mbi 65 për burrat. Tashmë është më e thjeshtë për ta verifikuar vërtetësinë e moshës, pasi

vetë ISSH ka akese mbi regjistrin themeltar të shtetasve. Megjithatë, qytetari duhet të dorëzojë një fotokopje të kartës së identitetit, e në rastet kur pretendon të marrë kompensime të tjera që i bashkëngjiten pensionit, duhet të dorëzojë edhe dokumente të tjera si certifikata familjare për të verifikuar pjesëtarët e familjes. Kur individit mendon se ka 40 vite punë, duhet të paraqesë librezën e punës dhe dokumentin që vërteton pagat që ka marrë nga 1 janari i 1994 e deri më sot. Për të gjithë ata që kanë punuar pas 1 janarit të vitit 1994 e deri më sot, listpagesat janë grumbulluar në arkivin e sistemit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore që funksionon edhe sot. Ndërsa për periudhat kur individit ka punuar para vitit 1994, shërbën librezat e punës dhe nuk është e nevojshme të sjellë vërtetime page. Kur individit humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute. Në këtë rast, personi bën një kërkesë deklarative në të cilën jepet të dhënat individuale të personit, paraqitet historiku i të gjitha punëve që ka bërë i siguruar. Dhe pas kësaj duhet të shpjegojë që vetë personi të fjalë kërkon të pajiset me një

KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE	
<b>Për pagat referuese deri më 1.1.1994 8.76;</b>	
► Për pagat e vitit 1994	<b>8.76;</b>
► Për pagat e vitit 1995	<b>7.05;</b>
► Për pagat e vitit 1996	<b>5.47;</b>
► Për pagat e vitit 1997	<b>5.47;</b>
► Për pagat e vitit 1998	<b>4.57;</b>
► Për pagat e vitit 1999	<b>3.71;</b>
► Për pagat e vitit 2000	<b>3.38;</b>
► Për pagat e vitit 2001	<b>2.89;</b>
► Për pagat e vitit 2002	<b>2.67;</b>
► Për pagat e vitit 2003	<b>2.39;</b>
► Për pagat e vitit 2004	<b>2.17;</b>
► Për pagat e vitit 2005	<b>1.97;</b>
► Për pagat e vitit 2006	<b>1.79;</b>
► Për pagat e vitit 2007	<b>1.71;</b>
► Për pagat e vitit 2008	<b>1.51;</b>
► Për pagat e vitit 2009	<b>1.39;</b>
► Për pagat e vitit 2010	<b>1.33;</b>
► Për pagat e vitit 2011	<b>1.28;</b>
► Për pagat e vitit 2012	<b>1.23;</b>
► Për pagat e vitit 2013	<b>1.18;</b>
► Për pagat e vitit 2014	<b>1.18;</b>
► Për pagat e vitit 2015	<b>1.02;</b>
► Për pagat e vitit 2016	<b>1.02;</b>
► Për pagat e vitit 2017	<b>1.00;</b>
► Për pagat e vitit 2018	<b>1.00.</b>

dokument të ri ku të konfirmohen të gjitha vitet e punës që individit ka kryer. Organet e sigurimeve shoqërore, janë të detyruara ta marrin kërkesën deklarative dhe të vënë në dijeni qytetarin që duhet të presë jo më shumë se 60 ditë, derisa të bëhen të gjitha verifikimet e nevojshme mbi të gjitha punët që ka bërë personi. Dokumenti, pra librezat e punës

mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vullsh apo dublikatë librezat. Në momentin kur ka dublikatë të librezës së punës me siguri ka një "ngërc" e menjëherë duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listpagesat që të vërtetojnë faktin që individit ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

## Kapen dhe dy të rinj me sasi të vogël marijuane

### Tentuan të kalojnë kufirin me 23 kg kanabis, arrestohet Maliq Kruja

**SHKODER**-Tre persona janë arrestuar në flagrancë në Muriqan, pasi u kapen me 23 kg kanabis. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se pas hekurave përfundoi Maliq Kruja, 54 vjeç, banues në Tiranë. Arrestimi i tij u bë pasi është paraqitur në pikën kufitare në Muriqan në dalje, me mjetin e tij tip 'Benz' me targë DC187ZA, ku nga kontrolli i ushtruar në vijën e dytë u gjetën dhe u sekuestruan 23 kilogramë kanabis. Po ashtu në këtë pikë kufitare u arrestuan edhe shtetasit, E. M., 31 vjeç, banues në Durrës dhe A. B.,

#### ARRESTIMET

Po ashtu në Muriqan u arrestuan edhe shtetasit, E. M., 31 vjeç, banues në Durrës dhe A. B., 26 vjeç, banues në Tiranë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në autobusin e linjës Shqipëri-Gjermani në sediljen e këtyre shtetasve, u gjet dhe u sekuestrua një sasi e vogël lëndë narkotike e dyshuar Cannabis Sativa.

26 vjeç, banues në Tiranë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në autobusin e linjës Shqipëri-Gjermani në sediljen e këtyre shtetasve, u gjet dhe u sekuestrua një sasi e vogël lëndë narkotike e dyshuar Cannabis Sativa. Materialet u referuan Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiranë, në ngarkim të shtetasit Maliq Kruja, për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve" parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, ndërsa në ngarkim të shtetasve E. M. dhe A. B. u referuan mate-



riale Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.

Fat i keq i tre hajdutëve shqiptarë në Itali, aksidentohen, një vdes

# Pranga grupit të shqiptarëve në Greqi

*Kathimerini: Mes të arrestuarve edhe dy policë grekë*

Njëmbëdhjetë persona janë arrestuar në Greqi ditën e djeshme si pjesë e një grupi kriminal që trafikonte drogë në disa qytete greke. Kathimerini raporton se mes të arrestuarve janë edhe dy policë grekë. Ata ishin implikuar në këtë aktivitet kriminal. Njëri prej tyre është anëtar i skuadrës kundër krimit të organizuar në policinë greke, kurse i dyti punon në komisaratin e Grevenas. Ndërkohë, 8 nga të arrestuarit e tjerë janë shqiptarë. Grupi kriminal drejtohej, gjithashtu, nga një shtetas shqiptar, i cili është identifikuar dhe është shpallur në kërkim. Sipas shtypi grek, ai kërkohet në të dyja vendet. Policia thotë se anëtarët e bandës shpërndanin kokainë dhe kanabis në disa qytete. Në një shtëpi në Athinë në rajonin e Atikës, u zbulua sasi droge dhe armët. Kjo shtëpi shërbente si bazë për magazinimin e lëndëve narkotike.

**ITALI**  
Një aksident fatal ka ndodhur në aksin rrugor që lidh Rivoltan me Pandinon në Itali, duke i shkakuar vdekjen e një shqiptari. Një bandë grabitësish shqiptarë që u përpoqën t'i iknin karabinierëve u përfshinë në një aksident rrugor, ku një nga tre



#### AKSIDENTI NE ITALI

Një aksident fatal ka ndodhur në aksin rrugor që lidh Rivoltan me Pandinon në Itali, duke i shkakuar vdekjen e një shqiptari. Një bandë grabitësish shqiptarë që u përpoqën t'i iknin karabinierëve u përfshinë në një aksident rrugor, ku një nga tre hajdutët gjeti vdekjen. Mediat italiane shkruajnë se mbrëmjen e shkuar rreth orës 22:30 minuta një makinë tip 'BMW', me tre shqiptarë në bord doli jashtë rrugës, duke lënë të plagosur rëndë edhe dy personat e tjerë.

hajdutët gjeti vdekjen. Mediat italiane shkruajnë se mbrëmjen e shkuar rreth orës 22:30 minuta një makinë tip 'BMW', me tre shqiptarë në bord doli jashtë rrugës, duke lënë të plagosur rëndë edhe dy personat e tjerë. Forcat e rendit dhe dy ambulanca shkuan menjëherë në vendin e ngjarjes duke transportuar të

Kathimerini raporton se mes të arrestuarve janë edhe dy policë grekë. Ata ishin implikuar në këtë aktivitet kriminal. Njëri prej tyre është anëtar i skuadrës kundër krimit të organizuar në policinë greke, kurse i dyti punon në komisaratin e Grevenas. Ndërkohë, 8 nga të arrestuarit e tjerë janë shqiptarë.

#### Arrestohet pas disa muajsh arrati juristi i hipotekës



**FIER**- Pas disa muajsh në arrati, është arrestuar juristi i ZRRP të Fierit, i cili akuzohet për korrupsion. Burime zyrtare nga policia pohuan se bëhet fjalë për Ervis Bregasin, 32 vjeç, banues në Cakran. Për juristin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me 26 maj të këtij viti kishte caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike". Rasti i abuzimit të juristit u bë publik në emisionin investigativ 'Fiks Fare', ku një qytetar denoncoi me zë dhe figurë 32-vjeçarin. Ky i fundit akuzohet se i kërkoi qytetarit 300 mijë lekë, në këmbim të certifikatës së pronës.

plagosurit për në spital. Trupi i pajetë i shqiptarit u nxor nga makina rreth orës 1:30 minuta, ndërsa mjeti i shkatërruar plotësisht u largua prej andej me kamion rreth orës 02:00 të mëngjesit të sotëm. Si pasojë e aksidentit, ka hum-

bur jetën 31 vjeçari shqiptar me iniciale A.K, banues në Cassano d'Adda, ndërsa kanë mbetur të plagosur rëndë dy bashkëkombësit e tij, ku njëri është transportuar për në spitalin e Brescias dhe tjetri në spitalin e Kremones.



## STUDIMET NË ITALI KRITERET

Voltiza Duro

Studentët e Universitetit të Tiranës, tashmë kanë mundësinë që të aplikojnë për bursa brenda datës 30 tetor të këtij viti në universitetin e La Sapienzës në Itali. Në faqen zyrtare të UT-së bëhet me dije se këto bursa studimi janë të vlefshme për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 e do të zgjasin 6 muaj, si për nivelin Bachelor ashtu edhe për Masterin e Doktoraturën. Të gjithë studentët e interesuar mund të aplikojnë për degë studimi si: Histori, Arkeologji, Filozofi dhe Etikë; Gjuhë e Huaj; Ekonomiks; Shkenca Politike; Psikologji; Sociologji; Gazetari; Kontabilitet; Financë-Bankë; Marketing; Administrim Biznes; Punë Sociale; Drejtësi; Biologji; Biokimi; Kimi; Fizikë; Matematikë; Infermieri; Shkenca Kompjuterike Statistikë etj. Këto bursa studimi mbulojnë kompensimin prej 850 euro në muaj për studentët si dhe kostot e udhëtimit, kjo në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. "Studentët që përfitojnë nga mobiliteti nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.", theksohet në njoftimin e Universitetit të Tiranës.

### APLIKIMI NË BACHELOR

Studentët e nivelit Bachelor që janë të interesuar të fitojnë bursën 6 mujore në Universitetin e Bolonjës, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës gjatë aplikimit. Respektivisht, ata duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze apo italiane; një kopje e Pasaportës; vërtetim studentit si dhe një listë notash. Gjithashtu, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe një letër motivimi në gjuhën angleze apo italiane në varësi të programit të studimit; certifikatën e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit); si dhe të ashtuquajturën "Learning Agreement". "Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit", citohe në njoftim. Studentët duhet të kenë kujdes që gjatë aplikimit në universitetin e La Sapienzës, të përzgjedhin lëndët të njëjta me ato që do të kryenin në semestrin e parë

Ja kush mund të kandidojë. Dokumentacioni që duhet të dorëzoni brenda 30 tetorit

# Aplikimi, bursa në Itali për studentët e Universitetit të Tiranës

*Njihuni me degët ku mund të kandidoni në Bachelor e Master*



## 850

**EURO NË MUAJ MBULIMI MUJOR**  
Këto bursa studimi mbulojnë kompensimin prej 850 euro në muaj për studentët si dhe kostot e udhëtimit, kjo në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Studentët që përfitojnë nga mobiliteti nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës.

## 30

**TETOR AFATI I FUNDIT**  
Studentët e Universitetit të Tiranës, tashmë kanë mundësinë që të aplikojnë për bursa brenda datës 30 tetor të këtij viti në Universitetin La Sapienza të Italisë. Në faqen zyrtare të UT-së bëhet me dije se këto bursa studimi janë të vlefshme për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 e do të zgjasin 6 muaj.

në fakultetin e Universitetit të Tiranës, në mënyrë që lëndët dhe kreditet të njihen kur të kthehen. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që studentët do të zhvillojnë në UT gjatë semestrin të parë, atëherë kur të kthehen sërish, studentët duhet të frekuentojnë që nuk përshtatet në Universitetin e Tiranës. "Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Sapienzës lëndët të njëjta me ato që do të kryenin në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillojnë në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillojnë lëndët që nuk përshtatet në Univer-

sitetin e Tiranës. Nëse ju nuk do të frekuentoni lëndët dhe nuk do të merrni kreditet në universitetin pritës por do të shkoni vetëm për hulumtim atëherë duhet ta përcaktoni këtë gjë në dokumentin Learning Agreement", theksohet në njoftim.

### APLIKIMI NË MASTER

Ndërkohë, të gjithë studentët që vazhdojnë studimet master e dëshirojnë që semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 ta kryejnë në universitetin e Bolonjës në Itali, duhet të paraqesin dokumentacionin brenda afatëve të përcaktuara. Kështu, kandidatët duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze apo italiane; një kopje të Pasaportës; vër-

tim studentit; diplomën e nivelit Bachelor ku duhet ti bashkëngjitet lista e notave. Gjithashtu aplikantët duhet të dorëzojnë edhe një listë notash të nivelit master të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze apo italiane në varësi të programit të studimit si dhe një letër motivimi e një certifikatë të gjuhës së huaj. Ashtu si në nivelin bachelor, studentët duhet të paraqesin kontratën "Learning Agreement". Të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, pranë Drejtorisë së Komunikimit, Sektori i Marrëdhënive me Jashtë si dhe t'i dërgojnë të skanuara po të njëjtin dokumentacion në e-mailin [iro@unit.edu.al](mailto:iro@unit.edu.al).

### APLIKIMI NË DOKTORATURË

Të interesuarit për nivelin Doktoraturë duhet të aplikojnë brenda 30 tetorit këtë dokumentacion: CV (në gjuhën angleze/italiane); listë e publikimeve; kopje e Pasaportës; vërtetim studentit (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane); listë notash doktorature (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane); letër motivimi si dhe një përkthim të temës së kërkimit (në gjuhën angleze/italiane në varësi të fushës së mobilitetit); letër të miratimit nga stafi akademik në Sapienza; certifikata e gjuhës së huaj niveli B1 (Italisht/Anglisht sipas programit të studimit) si dhe Learning Agreement.

### DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM PËR STUDENTËT E NIVELIT BACHELOR:

- CV (në gjuhën angleze/italiane);
  - Kopje e Pasaportës;
  - Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;
  - Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit);
  - Learning Agreement;
- Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:
- CV (në gjuhën angleze/italiane);
  - Kopje e Pasaportës;
  - Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Diplomë e nivelit Bachelor;
  - Listë notash e nivelit Bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Listë notash e nivelit Master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;
  - Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit);
  - \*Learning Agreement;
- Dokumentet e nevojshme për aplikim për nivelin Doktoraturë:
- CV (në gjuhën angleze/italiane);
  - Listë e publikimeve;
  - Kopje e Pasaportës;
  - Vërtetim studentit (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);
  - Listë notash doktorature (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);
  - Letër motivimi + Përkthim të temës së kërkimit (në gjuhën angleze/italiane në varësi të fushës së mobilitetit);
  - Letër e miratimit nga stafi akademik në Sapienza;
  - Certifikatë e gjuhës së huaj niveli B1 (Italisht/Anglisht sipas programit të studimit)
  - \* Learning Agreement

## SHKRIMTARET NE DIKTATURE

*Së shpejti libri më i ri, "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist", i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi*

Ekskluzive / Publikohet raporti sekret i Plenumit të XV-të të KQ, më 26 tetor 1965, i drejtuar nga Enveri

# Mehmeti: "Poeti Fatos Arapi s' pajtohet me realitetin tonë politik, konfuz në trurin e tij"

## Akuza e kryeministrit: "Sipas Arapit, tek ne s'ka lumturi, sepse s'ka drejtësi, s'ka ndjenja njerëzore"

Nga Dashnor Kaloçi

Një nga shkrimtarët që i nxori më shumë probleme regjimit komunist të para viteve '90-të dhe që i shpëtoi paqë hekurave të burgut, ka qenë Fatos Arapi, i cili u ndesh që në hapat e parë të krijimtarisë së tij letrare në fillimin e viteve '60-të me diktatin e egër komunist, për të shpëtuar prej tij vetëm me shembjen e atij regjimi. Gjë të cilën do ta shohim edhe në mjaft nga kapitujt pasardhës të këtij libri dhe jo vetëm, ku në disa Plenumet të Komitetit Qendror të PPSH-së dhe, gjithashtu, Byrosë Politike e sekretariatit të Komitetit Qendror, është marrë në analizë krijimtaria e tij dhe në raporte të mbajtura në ato mbledhje, Arapi është etiketuar pothuajse si "armik i popullit". Një nga këto Plenumet të Komitetit Qendror të PPSH-së, ku Arapi është etiketuar si "delja e zezë" është dhe ai i 26 tetorit të vitit 1966, i drejtuar nga vetë Enver Hoxha, me temë: "Rritja e rolit të letërsisë dhe i arteve në edukimin komunist të masave", ku raportin kryesor e mbajti Ramiz Alia. Pas atij raportit, fillimisht e para që e ka marrë fjalën, ka qenë Fiqërete Shehu, e cila pasi është solidarizuar me raportin, është ndalur te vepra e fundit e Fatos Arapit, me titull "Drama e një partizani pa emër", e cila, gjithashtu, ishte kritikuar ashpër dhe në raportin e mbajtur nga Ramiz Alia. Pas shumë diskutimeve, në fund të mbledhjes së atij Plenumi, fjalën e ka marrë kryeministri Mehmet Shehu, i cili i ka bërë një analizë të thellë krijimtarisë së Arapit, duke cituar mjaft nga poezitë e tij, njësoj sikur të ishte një kritik letrar nga më të përgatiturit nga ana profesionale dhe politike. Gjë e cila duhet thënë se ishte një gjë jo e zakonit për kryeministrin Shehu, pasi ai Plenum mbahej për Letërsinë dhe Artet, ku tonin mbledhjes ia jepnin zakonisht ata kuadro të lartë që e mbulonin atë sektor në rruget e partitë, dhe kësaj, Mehmeti nuk para "përzihej" shumë në ato punë. Po përse kishte ndodhur kjo, pra përse Mehmeti dhe bashkëshortja e tij e kishin sulmuar ashpër poetin Fatos Arapi? Lidhur me këtë, ka dhënë vetë versionin e tij, Fatos Arapi në mjaft biseda që ka bërë me autorin e këtij libri, por edhe publikisht në dy-tre shkrime dossier të "Gazeta Shqiptare", duke e argumentuar sulmin e Mehmetit, me mllëfin e vjetër që ai kishte me vëllanë e Fatosit, Vllas Arapin, ish-partizan në Brigadën e Parë Sulmuese, që komandonte Mehmeti. Sipas Fatosit, Mehmeti nuk ia falli kurrë Vlla-



si, faktin që ai; në vitin 1943 njoftoi fshehurazi "Xhepin", (Sadik Premtën) që të largohej menjëherë nga Vlora, pasi ai (Vllasi), do të eliminohej fizikisht me urdhër të Mehmetit nga një skuadër partizane e asaj brigade që e mbante Premtën të izoluar dhe nën kontroll të rreptë. Dhe mos e keqkuptoni i Premtës do t'i kushtonte shtrenjtë jo vetëm Mehmetit, por edhe Hys-

ni Kapos, gjë të cilën Enver Hoxha ua mbajti mbi kokë si "shpata e Damokleut" deri sa ishte gjallë, duke ua përmendur sa herë që kishte ndonjë pakënaqësi ndaj tyre. Dhe sipas Fatosit, (gjë e cila është konfirmuar edhe nga disa dokumente arkivore të bëra publike këtu vitet e fundit), pikërisht për atë shkak, Vllas Arapi u ekzekutua nga komunistët



vajzën e Kadriut), ndërsa babai i dhëndrit të Kadriut, Hajdar Aranitasi, ishte, gjithashtu, një nga funksionarët e lartë të atij regjimi. Gjithsesi këto mbeten për t'u parë, ndërsa në këtë kapitull po publikojmë me shkurtime disa nga dokumentet e Plenumit të XV-të, ku Mehmet Shehu, "kryqëzoi" poetin Fatos Arapi duke e konsideruar mes të tjerave si; "element që nuk pajtohej me atë realitet politik, pasi kishte konfuzion në trurin e tij".

### Fjala e hapjes së Plenumit nga Enver Hoxha

Në dokumentin arkivor të atij plenumi, (AQSH F.14. Aparati Komitetit Qendror. V. 1965, d. 2, fq. 1) pas rendit të ditës me temën që cituam më lart, shkruhet: "Plenumin e kryesoi sekretari i parë i Komitetit Qendror të PPSH-së, shoku Enver Hoxha, asistentin të gjithë kandidatët dhe anëtarët e Komitetit Qendror, me përjashtim të shokëve: Haki Toska, Nexhmije Hoxha të sëmurë, dhe Vito Kapo, Nesti Nase dhe Rrapi Gjermeni jashtë shpirtit.

### Zhvillimi i Mbledhjes

Shoku Enver Hoxha. Shokë, në këtë mbledhje jemi prezent 76 anëtarë dhe kandidatë të Komitetit Qendror, mungojnë me arsye pesë anëtarë dhe kandidatë, shumica është prezent dhe mbledhjen e deklaroi të hapur: Sipas rendit të ditës, që ju keni marrë, sot ne do të shqyrtojmë raportin e Byrosë Politike të KQ mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave, që do të mbajë anëtari i Byrosë Politike dhe sekretari i Komitetit Qendror të PPSH-së, shoku Ramiz Alia dhe diskutime. Jemi dakort që plenumi të zhvillojë punimet me këtë rend dite? Kush është dakort të ngrejë dorën (të gjithë shokët aprovojnë që plenumi të zhvillojë punimet me këtë rend dite). Si të ftuar në këtë mbledhje marrin pjesë sekretarët e parë të KP të rrethëve që s'janë anëtar plenumi, ministrat dhe njerëz të letërsisë dhe artit. Jeni dakort që këtë shokë të marrin pjesë në plenum? Kush është dakort të ngrejë dorën. (Të gjithë shokët u shfaqën dakort) Atëhere, shokë, fillojmë".

### Diskutimi i Fiqret Shehut

Shokë, duke bërë një analizë të gjithanshme e të thellë punës së der-



Mbi to rëndon vepra penale "Ndotje e ajrit" në bashkëpunim

KRUJE

**P**olicia e Krujës ka ndër marrë një operacion kundër ndotjes së mjedisit, ndërsa në pranga kanë përfunduar 9 persona. Burime zyrtare pohuan se në mënyrë të përsëritur, gjatë prodhimit të gëlqeres, këta persona akuzohet se përdornin si material djegës materiale të ndryshme plastike, sintetike, mbetje fasonerie dhe goma automjetesh. Një aktivitet i tillë ishte shqetësim i madh për banorët e zonës duke rrezikuar shëndetin dhe jetën e tyre dhe shkaktonte një dëm i madh në ambient. Ndërkohë, policia sekuestroi dhe një kamion të ngarkuar me mbetje fasonerie. Pas informacioneve të siguruar nga Strukturat Policore, si dhe nisur nga shqetësimet e banorëve, mbrëmjen e djeshme u ushtrua kontroll i befasishtëm në Krastë. Si rezultat nga Policia e Krujës janë arrestuar në flagrancë shtetasit: Lulian Agiçi 38 vjeç, banues në Krujë, Mirgen Sheta 37 vjeç, banues në Krujë, At-dhe Sula 43 vjeç, banues në Krujë, Ilir Sula 34 vjeç, banues në Krujë, Bajram Sula 64 vjeç, banues në Krujë, Liradin Kraja 61 vjeç, banues në Krujë, Fatmir Shullazi 47



vjeç, banues në Krujë, Ilir Babasi 48 vjeç, banues në Krujë, Dalip Islamaj 49 vjeç, banues në Krujë. Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar një mjet kami-

on tip Mercedes Benz i ngarkuar me mbetje fasonerie dhe plastike të rrezikshme që do të përdorehin për djegie në këto furra në pronësi të shtetasit I.Babasi. Ma-

terialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për veprime të mëtejshme për veprën penale "Ndotja e ajrit" në bashkëpunim, mbetur në tentativë.

# Digjnin goma për furrat e gëlqeres, në pranga 9 vetë

## Banorët e Krujës denoncuan ndotjen e mjedisit

### TE PRANGOSUR

- Lulian Agiçi 38 vjeç, banues në Krujë;
- Mirgen Sheta 37 vjeç, banues në Krujë;
- At-dhe Sula 43 vjeç, banues në Krujë;
- Ilir Sula 34 vjeç, banues në Krujë;
- Bajram Sula 64 vjeç, banues në Krujë;
- Liradin Kraja 61 vjeç, banues në Krujë;
- Fatmir Shullazi 47 vjeç, banues në Krujë;
- Ilir Babasi 48 vjeç, banues në Krujë;
- Dalip Islamaj 49 vjeç, banues në Krujë.

## Studentë! Sigurimi i duhur për ju!

la vlen ta studioni!

Duke filluar nga vetëm 2,000 lekë/vit, SiCRED garanton përfitime dhe mbulim të shpenzimeve në rast të të papiturave shëndetësore apo aksidentale deri në 1,200,000 lekë. Me kartën e sigurimit personale përfitoni deri në 60% zbritje në spitalet/klinikat private të rrjetit mjekësor SiCRED.



Sigurim  
për Jetën



Sigurim nga  
Aksidentet



Sigurim nga  
Sëmundjet Kritike



**SiCRED**  
Shoqëri Sigurimi Jete

**SIGURIMI  
JETA e STUDENTËVE**

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: **Tel:** +355 4 22 37 549 | **Cel:** +355 69 20 84 026 | **e-mail:** shitje@sicred.com.al




## MJEKU POPULLOR




Ylli Merja:  
Zmadhimi i mëlçisë,  
si ta trajtoni me  
bimë mjekësore

## KESHILLA



9 ushqimet  
që eliminojnë  
parazitët  
e zorrëve

# Kim Drasa:



◆ Mjeku urolog:  
Kujdes me  
përdorimin e  
duhanit e  
ushqimet e  
konservuara,  
shkaktarë për  
sëmundjen

## Kanceri i vezikës urinare dhe mënyrat e trajtimit të tij

"Meshkujt, kategoria më  
e prekur nga ky tumor"

• Si duhet të konsumohet kafeja e mëngjesit. Përdorni vajin e rignonit kundër infeksioneve.

Mjeku urolog: Kujdes me përdorimin e duhanit e ushqimet e konservuara, shkaktarë për sëmundjen

# Kim Drasa:

## Kanceri i vezikës urinare dhe mënyrat e trajtimit të tij

"Meshkujt, kategoria më e prekur nga ky tumor"

Voltiza Duro

**K**anceri i vezikës urinare është një sëmundje që po pëson një përhapje gjithmonë e më të gjerë këto vitet e fundit. Në një intervistë për suplementin 'Life Pages' në 'Gazeta Shqiptare', mjeku urolog dhe seksolog, prof. dr. Kim Drasa thekson se duhanpirja, ushqimet e konservuara, infeksionet e ndryshme, apo disa lloje punësh specifike luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sëmundjes. Më tej mjeku tregon të gjitha simptomat kryesore të sëmundjes dhe mënyrat e diagnostikimit të saj si dhe bën me dije se medikamentet anti-kanceroze kanë qenë përdorur intravezikalisht për kancerin e vezikës urinare për afërsisht 30 vite, me të dhëna modeste në parandalimin e përsëritjes, por jo në parandalim e avancimit të gradës kanceroze.

**Cfarë është kanceri i vezikës urinare dhe cilat janë kategoritë më të prekura?**

Kanceri i vezikës urinare është një nga 11-të sëmundjet malinjne në të gjithë botën. Incidenca e kancerit të vezikës urinare ka pësuar rritje gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Kanceri i vezikës urinare është i katërti më tepër i zakonshëm tek meshkujt dhe i dhjetë tek femrat. Ky është një nga shkaqet më frekuentet të vdekjeve nga kanceri. Incidenca është më e lartë në popullsinë e plakur, me një mesa-

tare moshe nga 60-65 vjeç.

**Mund të përmendni disa prej shkaqeve kryesore që ndikojnë në zhvillimin e sëmundjes?**

Duhanpirja është faktor rreziku më i përcaktuar për shkaktimin e kancerit të vezikës urinare. Faktorë të tjerë rreziku përfshijnë: ekspozimin ambiental ndaj Hidrokarbureve dhe Aminës aromatike. Industritë ku punonjësit mund të ekspozohen ndaj rrezikut kancerogjen janë: manufacturat me përdorim bojrash; përdorim gomash; me gas qymyrguri; me ujrat e zeza; me ndeje zjarri etj. Ndër faktorët dietikë që ndikojnë janë kafeinna; ëmbëlsirat artificiale. Ndërkohë medikamentet Cyclophosphamidet dhe Phenacetina kanë treguar se kanë lidhje me kancerin e vezikës urinare. Radioterapia për kancerin cervical të mitrës lidhet me katër herë rritje të rrezikut të kancerit të vezikës urinare. Edhe infeksionet ose

shfaqjes së sëmundjes.

**Cilat janë simptomat kryesore që shfaqin pacientët e prekur nga kanceri i vezikës urinare?**

Pacientët shfaqin hematuria pa dhimbje (dalja e urinës me gjak duket me sy të lirë dhe pa dhimbje) por mund të paraqesin edhe hematuria mikroskopike që nuk duket me sy të lirë por vetëm me mikroskop. Pacientët shfaqin edhe simptoma irritative si dysuria, frekuencë urinimi, dhimbje në fundin e barkut. Në pacientët 50 vjeç e sipër që vuajnë nga infeksione recurren të traktit urinar duhet menduar se mund të kenë ndonjë tumor të pazbuluar. Edhe ata që kanë simptoma lokale ose me përhapje në distancë si dhimbje shpine; humbje në peshë; mungesë fuqie; anoreksi; dhimbje kockash; fraktura patologjike; kollë; dhimbje koke; dhimbje barku duhet të bëjnë një diagnostikim.

**Ku lokalizohet më së shumti**



inflamacionet kronike kanë rol në zhvillimin e sëmundjes. Incidenca e kancerit të vezikës urinare varion me nivelin e sasisë së lëngjeve që pimë, pra sa më shumë lëngje të pimë aq më e ulët është incidenca

**kjo sëmundje?**

Pjesa më e madhe e kancerit të vezikës urinare lokalizohet në pjesën e murrin të vezikës urinare, e cila quhet Urothelium. Carcinoma e lokalizuar në Urotheliumin




Prof. dr. Kim Drasa

e vezikës urinare, kategorizohet gjerësisht në: jo-muskul-invasive kanceri i vezikës urinare; dhe kanceri muskul invaziv (përfshihet muskulatura) e vezikës urinare. Afërsisht 75% e tumoreve të vezikës urinare paraqiten si NMIBC. Klasifikimi patologjik i Kancerit të vezikës urinare, i cili nuk ka kapur muskulaturën e saj kategorizohet në tumor primar, pra në fazën fillestare, i cili nuk zbulohet; To-tumor ku nuk ka evidencim të tumorit primar; Ta- tumor papilar;

numri; konfiguracioni dhe ndonjë anomalitet të mukozës së vezikës urinare.

**Cilat janë mënyrat e trajtimit të kancerit të vezikës urinare?**

Medikamentet anti-kanceroze kanë qenë përdorur intravezikalisht për kancerin e vezikës urinare për afërsisht 30 vite, me të dhëna modeste në parandalimin e përsëritjes por jo në parandalim e avancimit të gradës kanceroze. Agjentët, të cilët përdoren zakonisht me demonstrim aktiviteti, përf-



jo invasive; Tis- CIS, 'tumor i shesh-të' si dhe T1-tumor që ka invaduar indet lidhëse sub-epiteliale.

**Si bëhet diagnostikimi i sëmundjes?**

Për të zbuluar nëse një pacient është i prekur nga tumor i vezikës urinare duhet të bëhet diagnostikimi sipas radhës: të shihet historiku gjithë përfshirës; të kryhet ekzaminimi fizik; më tej të vijohet me Cysto-uretroskopia. Po ka tumor në vezikën urinare vlerësohen tiparet makroskopike siç janë madhësia tumorit; vendndodhja;

shijnë: Thiotepa; Doxubicin; Epiburicin dhe Mitomycin C.

**Cilat janë llojet e kimioterapisë që përdoren për kurimin e sëmundjes?**

Kimioterapia intravezikale ka tre lloje përdorimi: Profilaktike; Terapeutike; dhe Adjunctive. Medikamentet kimioterapeutike kanë demonstruar vlera terapeutike të limituara në zhdukjen e kancerit ekzistues siç janë tumoret reziduale ose CIS. Studime klinike kanë treguar se imunoterapi BCG, janë më superiorë në rezultat.

Voltiza Duro

Zmadhimi i mëlçisë nuk dalohet që në fillimin e saj, pasi nuk ka simptoma për një kohë të gjatë. Testi i pare mund të bëhet nga çdo individ në shtëpi e për këtë mund të prekeni direkt poshtë brinjëve në pjesën e djathtë. Nëse keni zmadhim të mëlçisë do të ndjeni një pjesë të butë që vazhdon poshtë brinjës, mund të jetë e rregullt ose e çrregullt në formë. Ndërsa një mëlçi normale nuk ndjehet menjëherë sa e prekeni pjesën poshtë brinjës, pra duhet të shtypni në thellë për ta dalluar. Ndërsa për të analizuar saktësisht madhësinë e shëndetin e mëlçisë suaj duhet të bëni një eko. Gjithashtu, analizat e gjakut janë të rëndësishme për të kontrolluar shëndetin e këtij organi, pasi tregojnë sekretimin e enzimave nga mëlçia, ALT rritet kur rritet numri i qelizave të vdekur të mëlçisë, pra kur është e dëmtuar e lëshon në gjak më shumë këtë enzimë. ALT qëndron brenda në mëlçi dhe kryen funksione si tretja, ruajtja e vitaminave e mineraleve, tretja e toksinave etj. Kur vdesin qelizat e mëlçisë, ALT çlirohet në gjak.

Simptomat e sëmundjes dallohen vonë e mund të jenë zverdhje e të bardhës së syve, lodhje dhe dobësi, humbje oreksi, humbje peshe, ose gjendje të fikëti. Gjithashtu, një simptomë mund të jetë mbajtja e lëngjeve në organizëm që shkakton fryrje të këmbëve. Individët mund të ndjejnë fryrje të barkut ose dhimbje të tij. Një diagnostikim për mëlçinë e dëmtuar janë edhe gërvishtjet e lehta në lëkurë që krijojnë fryrje ose ngelen shenja të kuqe për shumë kohë, dhe fillojnë të krijohen angioma.

**Shkaku i zmadhimit të mëlçisë**

Zmadhimi i mëlçisë ndodh për arsye të ndryshme. Mund të shkaktohet nga faktorë si mënyra e jetesës dhe dieta, por edhe nga sëmundje më të rrezikshme si hepatiti apo kanceri. Kjo sëmundje shkaktohet nga konsumimi i tepërt i alkolit, nga diabeti ose dieta e varfër pa minerale vitamina ose aminoacide. Gjithashtu, konsumimi i tepërt i ushqimeve të konservuara, ose rritja e toksinave në organizëm janë faktorë të sëmundjes. Gjithashtu, zmadhimi i mëlçisë shkaktohet nga dhjamosja e saj dhe diabeti. Nëse hepatiti kalon në cerozë, atëherë fillon degradimi i mëlçisë dhe kështu fillon zmadhimi i saj. ALT e lartë tregon rritjen e qelizave të vdekur të mëlçisë dhe zemrës, prandaj fillon dobësimi i të dyja organeve. Gjithashtu, zmadhimi i mëlçisë mund të shkaktohet nga kanceri në mëlçi apo në organe të tjera, ose në rastin kur kanceri është në fazë të avancuar dhe ka krijuar metastaza atëherë mëlçia fillon të zmadhohet. Prandaj është e rëndësishme që kur individ ka mëlçi të zmadhuar të kontrollohen të gjitha organet,



Mjeku popullor: Ja cilat janë simptomat kryesore të sëmundjes, si bëhet diagnostikimi

# Ylli Merja: Zmadhimi i mëlçisë, si ta trajtoni me bimë mjekësore

*"Përdorni gjembin e gomarit dhe kungullin e egër"*



Mjeku popullor Ylli Merja

minimalisht me eko dhe analizë gjaku, për t'u gjetur shkaku i vërtetë i sëmundjes. Nëse gjendet shkaktari mëlçia mund të vijë në normë sërish pasi qelizat e mëlçisë vdesin çdo 3-4 ditë normalisht, dhe kështu çdo muaj qelizat e saj arrijnë të rigjenerohen komplet.

**Trajtimi**

Për të trajtuar sëmundjet e mëlçisë duhet gjetur shkaku i sëmundjes. Ky organ ka mbi 1000 funksione në organizëm, dhe zmadhimi i saj mund të

ndodhë për shkak të mbingarkesës së funksioneve të saj. Prandaj për trajtimin e sëmundjes duhet kontrolluar si fillim dieta, konsumimi i alkolit dhe duhanit, mbipesha ose hepatiti. Hapi i parë është dobësimi pasi ulja e peshës është shumë pozitive për mëlçinë pasi ulim garkesën e punës së saj, pra sa më pak ushqime të hyjnë në stomak aq më pak enzima duhet të prodhohen nga mëlçia për tretjen e tyre.

Hapi i dytë është dieta e kontrolluar: konsumoni ushqime jeshile, domate, ushqime që përm-

bajnë antioksidante, patëllxhanët janë shumë të këshillueshme pasi stimulojnë qelizat e reja të mëlçisë të formohen në normë, vitaminë C, avocad, banane, xhinxher, peshk, limon, patatet e ëmbla. Mund të konsumoni edhe turmeric, tashmë shumë i njohur për vetitë e tij antikancerogjene dhe rigjeneruese, por edhe vaji i farave të zeza ka përbërës të fuqishëm për rigjenerimin e mëlçisë.

**Bimët mjekësore**

Këshillohet të përdoret gjembi i gomarit pasi janë bërë shumë punë kërkimore rreth vetive pozitive që

ka kjo bimë tek rigjenerimi i mëlçisë. Është një bimë shumë e fuqishme që vepron direkt në qelizat e mëlçisë duke i rigjeneruar ato dhe duke i rikthyer mekanizmat në normë si dhe ndihmon në nxjerrjen e toksinave, mineraleve të rënda, dhe alkolit nga organizmi madje pastron gjakun në tërësi. Një bimë tjetër shumë e fuqishme është qumështorja, e cila pastron gjakun nga alkoli, dhe nga toksinat, pra mbulon punën e mëlçisë, pastron qelizat e saj, ndihmon në sekretimin e enzimave dhe rregullon sasinë e sekretimit të tyre, ka veti të fuqishme antiinflamatore. Të gjitha këto efekte janë provuar në laborator. Kungulli i egër është një bimë shumë e fuqishme që pastron mëlçinë nga hepatiti, toksinat dhe forcon sistemin imunitar. Duhet përdorur vetëm me udhëzim nga një profesionist pasi përdorimi pa rekomandimin e duhur mund të jetë i rrezikshëm. Ushqimet e dëmshme janë: sheqeri, biskotat, çokolatat që përbëjnë sheqer të përpunuar. Të dëmshme janë edhe ushqimet e gatshme, si torta të ndryshme të paketuara, pijet me gaz. Majdanozi është shumë i këshillueshëm të përdoret, pasi pastron gjakun, tret yndyrat në gjak dhe rregullon qarkullimin e tij në vena e arterie.

Për pastrimin e mëlçisë mund të përdoret edhe lëng frutash: karota, rrënjë panxhari, majdanoz, xhinxher, qumështore e njomë, dhe gjembgomar.



Parazitët e zorrëve, ose siç njihen në gjuhën popullore krimbat e barkut, janë një infeksion shumë i shpeshtë që mund të paraqiten te çdokush. Krimbat janë parazitët të bardhë dhe të vegjël që infektojnë organizmin. Ata duken si fije pambuku dhe janë të gjatë nga 2-13 milimetra. Këta parazitët prekin zakonisht gjysmën e fëmijëve nën moshën 10 vjeç, por edhe të rriturit. Rreziku që anëtarët e tjerë të familjes të infektohen është 75%. Mungesa e higjienës si moslarja e duarve pasi shkoni në tualet ose kontakti me objekte që mbajnë vezë të krimbave janë dy nga arsyet kryesore që çojnë në shfaqjen e tyre. Simptoma kryesore e pranisë së këtyre parazitëve është kruajtja në pjesën e poshtme, zona e anusit, e cila përkeqësohet gjatë natës dhe mund të prishë gjumin; zorra mund të jetë e bllokuar dhe si pasojë shkakton probleme me jastëqitjen; diarre ose gjak në feçe. Përkundër asaj që mendojnë shumë njerëz, parazitët që rriten dhe shumohen brenda organizmit të njeriut vijnë në shumë forma dhe madhësi dhe janë një shqetësim shëndetësor përtej kufijve të vendeve të varfra me kujdes të dobët shëndetësor. Hulimitet e fundit nga Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve (CDC) prezantuan vlerësimet tronditëse se si përhapen organizmat parazitare në trupin e njeriut. Parazitët shpesh janë mikroskopik dhe më së shpeshti përhapen përmes ujit dhe ushqimi dhe prekin një pjesë dërmuese të njerëzve. Për t'i rikthyer trupit balancën natyrale duhet të konsumojnë sa më shumë ushqime organike me veti anti-parazitale. Më poshtë mund të gjeni disa prej ushqimeve që do të eliminojnë plotësisht parazitët nga trupi juaj. Shumë njerëz jetojnë me parazitë në trupin e tyre pa e kuptuar. Parazitët janë mikroorganizma që jetojnë dhe ushqehen mbi organet e tjerëve. Disa prej tyre mund të jenë shkaktarët direkt të sëmundjeve, ndërsa të tjerë shkaktojnë sëmundje për shkak të toksinave që prodhojnë. Këto mikroorganizma të rrezikshme hyjnë në trupin tonë nga goja ose lëkura. Risku i infektimit rritet kur gjendemi në vende të mbushur me parazitë dhe kur udhë-

# 9 ushqimet që eliminojnë parazitët e zorrëve



tojmë në vende që karakterizohen nga ushqimi dhe uji i kontaminuar. Rreziku rritet për shkak të higjienës së dobët ose kontaktit me kafshët.

### Hudhra:

Ajo mund të jetë ushqimi më i përshtatshëm në këtë listë dhe ka një gamë të gjerë përfitimesh shëndetësore. Është veçanërisht e dobishme në parandalimin e krimbave të rrumbullakët. Hudhra ka super fuqi. Ajo ka treguar eficientë e saj në luftën kundër virusëve, kërpudhave, baktereve, parazitëve dhe kancerit.



### Qepa:

Qepa është shumë e pasur me komponentë squfuri me veti anti-parazitare. Lëngu i qepëve është shumë efektiv për krimbat intestinalë. Nëse vuani nga parazitët, pini dy lugë çaji lëng qepe në ditë për dy javë.

### Vaj kokosi:

Nivelet e larta të yndyrave të ngopura i japin vajit të kokosit aftësinë të eliminojë parazitët e zorrëve. Detoksifikon sistemin dhe



parandalon zhvillimin e parazitëve. **Farat e kungullit:**

Farat e kungullit kanë një efekt natyral antiparazit në sistemin tretës. Farat në vetvete nuk i vrasin parazitët, por ndihmojnë në nxjerrjen e tyre jashtë nga trupi.

### Ananasi:

Ky frut i shijshëm tropikal i

përqendrimin e lartë të acideve yndyrore në to.

### Vaji i rigonit:

Vaji i rigonit ka veti të jashtëzakonshme antioksiduese, antivirale, antiinflamatore dhe antibakteriale.

### Karafil:

Besohet se është e vetmja bimë që shkatërron totalisht vezët e krimbave. Nëse përdoret bashkë me arrën e zezë dhe me Artemisia Absinthium, shkatërron totalisht ciklin jetësor të parazitave. Karafil ka një funksion të lartë në parandalimin e parazitëve në zorrë pasi është antibakterial dhe antimykotik.

### Trumza:

pasur në bromelinë, ndihmon në nxjerrjen jashtë trupit të disa parazitëve infektuese.

### Bajamet:

Ndihmojnë për të pastruar dhe zvogëlojnë zhvillimin e parazitëve intestinalë. Efektet antiparazitale të bajameve mund të lidhen me

Trumza është një nga bimët më të mira që stimulojnë tiroiden, gjëndrën më të madhe të sistemit imunitar. Trumza ndihmon në stimulimin e mbrojtjes natyrale të trupit. Vaji i trumzës mund të eliminojë një sërë parazitësh, në zorrën e trashë.



# Këshilla

## Si duhet të konsumohet kafeja e mëngjesit

Një kafe në mëngjes me miqtë apo me familjen para se të fillojmë ditën, është një rutinë që duket sikur na relakson. Por prezente gjithmonë është edhe pyetja, nëse e do me sheqer apo pa sheqer filxhanin e kafesë. Ka patur gjithmonë diskutime përse i përket mënyrës sesi duhet të jetë një filxhan kafeje që të mos ndikojë negativisht në shëndetin tonë. Kafeja e zezë ka vlera të larta ushqyese nëse ju zgjidhni mënyrën e duhur për ta pirë. Dhe nëse jeni nga ata persona që nuk e mendoni dot ditën pa kafe, bëni mirë të mësoni sesi duhet të jetë ajo.

Si ndikon kafeja në peshën tonë?

Kafeja e pastër dhe zezë, nuk ndikon në kilogramët tuaj. Ato që i rritin kaloritë kafesë, janë përbërësit që ju i shtoni, si qumështi, sheqeri, kremi apo kur e shoqëroni me biskota. E pini kafen në një filxhan të madh, me qumësht, sheqer apo krem? Nëse po, dijeni që një kafe e tillë mund t'ju vësh-tirësojë humbjen e peshës. Sepse një filxhan i tillë kafeje me elementë të shtuar mund të shkojë deri në 240 kalori apo dhe më shumë. Dhe vetëm duke pirë 3 filxhanë të tillë, ju keni marrë gjysmën e numrit të kalorive që ju duhet në një ditë për të humbur peshë.

Mënyra më e mirë për të pirë kafen!

Ajo duhet të jetë një kafe e zezë e pastër dhe pa sheqer. Kështu ne



nuk marrim kalori, por vlerat e kafesë së zezë duke shmangur sheqerin, i cili duhet të jetë sa më pak prezent në jetën tonë. Edhe nëse nuk e pini dot kafen pa sheqer, mundohuni të përdorni sheqerin kaf, ose ti shtoni pak mjaltë. Në këtë rast ju do të siguron vlerat e

saj ushqyese të cilat janë: proteinat; acidet organike; ketonet; aldehydet

Gjithashtu kafja njihet për vetitë e saj si një antioksidant shumë i mirë e ju duhet të përfitoni nga vitaminat që mban kafeina si, B2, B3, B5.



## Përdorni vajin e rigonit kundër infeksioneve

Vaji i rigonit rekomandohet për të trajtuar infeksione të sistemit të frymëmarrjes, inflamacionin kronik, infeksionet urinare dhe verdhëzën.

Studimet laboratorike thonë se ky vaj është i fuqishëm kundër baktereve, sidomos atyre të transmetuar nëpërmjet ushqimit. Rigoni është shumë i pasur me kalcium, magnez, zink, kallum, bakër dhe mangan. Vaji i tij është i sigurt për konsum, madje mund të merret së bashku me antibiotikët për një luftë efikase kundër këtyre mikroorganizmave. Ai mund të pastrojë të gjithë sistemin e frymëmarrjes, sepse përmban flavonoidë dhe substanca të tjera natyrale me efekt zhbllokues. Ekspertët e mjekësisë popullore thonë se mjaftojnë 3 pika vaj rigoni në ditë për 4 ditë me radhë, për të përmirësuar shëndetin dhe për t'u shëruar nga simptomat e të ftohurës apo infeksioneve. Këto pika ju mund t'i shtoni edhe në një gotë me lëng portokalli. Një alternativë tjetër është t'i tresni këto tre pika në një gotë me ujë dhe ta pini atë.

Ekspertët rekomandojnë se vaji i rigonit ka aftësi të forta kundër baktereve ndaj nuk duhet tepruar me të. Sipas tyre, njerëzit mund të pinë dy deri në tre pika me vaj esneclal në ditë dhe jo më shumë. Arsyja e këtij rekomandimi është se vaji rigonit mund të shkatërrojë bakteret e këqija dhe të mira në organizëm. Rigoni është përdorur në mjekësinë popullore të Kinës, Greqisë dhe Romës së Lashtë për 5000 vjet me radhë. Në mitologjinë greke, ishte Afërdita ajo që e krijoi rigonin si një simbol të lumturisë. Për të përgatitur vajin e rigonit në shtëpi lu nevojiten: dy filxhanë të mbushur plot me gjethe rigoni; 1 filxhan me vaj ulliri ekstra të virgjër; kavanoz qelqi me kapak. Lajeni rigonin me ujë të bollshëm dhe më pas thajeni. Gjethet hidhini në kavanozin e qelqit dhe ngjishini në pjesën fundore që të çlirojnë sa më shumë vaj esneclal. Hidhni vajin e ullirit sipër tyre dhe përziejini. Ngrohni atë në mikrovalë ose në një enë. Pas hedhjes së vajit të ullirit në kavanoz, mbylleni kapakun dhe lëreni mënjane për një deri në dy javë. Mbajeni kavanozin në një vend të freskët dhe të errët. Tundeni atë rregullisht. Me kalimin e ditëve, lëngu do të marrë një ngjyrë të ndezur të kafentë. Më pas kullojeni dhe ruajeni vajin në kavanoz qelqi në frigorifer. Vaji i rigonit lufton inflamacionin dhe është i pasur me antioksidantë gjë që e bën një thesar të vërtetë për sistemin imunitar.

Fushëbetejat politike të Kancelares, pikat e dobëta dhe të forta

# Vjeshta e stuhishme e Angela Merkelit

*Politikania e hekurt gjermane, analiza e 13 vjetëve në pushtet*

Unioni i të Rinjve të CDU-së, zgjedhjet në Bavari dhe Hessen, kongresi i partisë CDU në dhjetor. Këto janë disa fushëbeteja politike të Kancelares Merkel. Por sa e fuqishme është ende ajo? Disa analistë e vlerësuan pozitivisht fjalimin e Merkelit në fundjavën që shkoi para rinisë së partisë konservatore, CDU. Ajo i bëri të rinjtë të dukën të vjetër, thotë gazeta "Welt." Merkel mbajti një fjalim me vetëkritikë, por edhe me dëshirën për kundërsulm. E pikërisht para Unionit të të Rinjve të CDU-së, që paraqitet më konservator se partia mëmë dhe prej kohësh ndjek një kurs opozitar kundër Kancelares. Ndaj Merkelit në fundjavë pati kritika, por jo revolucion. Një pikë në avantazh për kancelaren.

**Ora po troket, por sa shpejt?**

Merkel është mësuar me kritikën ndaj saj. Në fillim të mandatit të parë si kancelare në vitin 2005 thuej, se Merkel nuk është aq e pjekur politikisht për detyrën e kancelares. Në vitet e më pasme u zhvilluan zgjedhje me humbje për CDU, por Merkel mbeti në pushtet. Në shumë raste ajo dështimet e saj i ka zgjidhur duke

**ANALIZA**  
Merkel është mësuar me kritikën ndaj saj. Në fillim të mandatit të parë si kancelare në vitin 2005 thuej, se Merkel nuk është aq e pjekur politikisht për detyrën e kancelares. Në vitet e më pasme u zhvilluan zgjedhje me humbje për CDU, por Merkel mbeti në pushtet. Në shumë raste ajo dështimet e saj i ka zgjidhur duke "ndenjur", siç thonë gjermanët.



**WOLFGANG MERKE**

Ajo që të bën të jesh pro transferimit të rregullt është, se nuk ka asnjë pasues aq karizmatik që mund t'i mbledhë kritikët e Merkelit. Politologu, Wolfgang Merkel mendon, se "nëse Merkel nuk reziston, atëherë unioni ka një problem të madh". Nuk ka një "figurë bindëse". Megjithatë trazirat kërcënojnë të vijnë. Sepse nga kjo fundjavë Merkelin e përfshin një stuhia politike.

"ndenjur", siç thonë gjermanët. Këtë e kujtojnë jo pak vetë këto ditë në Berlin, kur - ndoshta me ndërkohë - bëhet thirrje për fundin e Kancelares. Që fundi një çast vjen, këtë e dinë të gjithë. Çështja që shtrohet është: Kur? Merkel vetë thotë, se ajo është e zgjedhur për këtë legjislaturë dhe ajo zgjat deri në vitin 2021. Por ajo do ta moderojë mirë transferimin e pushtetit, thonë shumë vëzhgues, ndoshta në mesin e mandatit. Në fund të fundit bëhet fjalë edhe për trashëgiminë e saj si kancelare. Por shumë spekulojnë se krizat e der-

itanishme në koalicionin qeveritar do ta thejnë kancelaren e do ta bëjnë të largohet. Dhe kritikën bëhen gjithnjë e më të lartë.

**Kërkohen pasues për Merkelin**

Ajo që të bën të jesh pro transferimit të rregullt është, se nuk ka asnjë pasues aq karizmatik që mund t'i mbledhë kritikët e Merkelit. Politologu, Wolfgang Merkel mendon, se "nëse Merkel nuk reziston, atëherë unioni ka një problem të madh". Nuk ka një "figurë bindëse". Megjithatë trazirat kërcënojnë të vijnë. Sepse

nga kjo fundjavë Merkelin e përfshin një stuhia politike. Zgjedhjet në Bavari, ku partia simotërë CSU duket se mund të pësojë një humbje historike. CDU qeveris prej vitesh me shumicë absolute. Ndërkohë në sondazhe ajo kap tani rreth 35% të votave. Mund të ketë jo pak vetë që do t'ia hedhin Merkelit fajin për këtë dështim. Kryetari i CSU-së, Horst Seehofer është edhe ministër i Punëve të Brendshme. Dy javë më vonë pasojnë zgjedhjet në landin e Hessenit. Atje qeveris CDU me Të Gjelbrit, e ky koalicion me gjasë mund të mos

zgjidhet më. Kjo do të ishte një tjetër goditje për kancelaren.

**Probleme në përgjithësi të partitë popullore**

Që sondazhet kanë vlera të tilla kaq të dobëta lidhet me konfliktet e hapura në qeveri. Rasti tipik ishte mënyra e veprimit mes ish-presidentin e Mbrojtjes Kushtetuese, Hans-Georg Maaßen. Në Gjermani vlen parimi i unitetit. Vetëm kështu binden votuesit. Por megjithatë partitë popullore të njohura si ajo konservatore dhe SPD po zvogëlohen gjithnjë e më shumë. Ndërkohë të Gjelbrit liber-

alë dhe partia populiste, AfD po shtojnë votat. Disa madje i shohin këto parti si partitë e reja të forta në plan afatgjatë. Ato janë pole të konfliktit të ri për globalizimin, thotë politologu Werner Patzelt.

Që pushteti i Angela Merkelit dobësohet e tregon këto ditë edhe në një intervistë të deputetit të CDU-së dhe mjaft i fuqishëm tek konservatorët në landin Renani Veriore dhe Vestfal. Në një intervistë për Spiegel ai kërkoi ndryshime strategjike dhe personeli. Kritika vijnë edhe nga ministri aktual i Shëndetësisë, Jens Spahn dhe Carsten Linneman, kreu i Shoqatës së Ekonomisë të CDU/CSU-së. Edhe 50 vjeçari Ralph Brinkhaus që fitoi papritur kundër të preferuarit të Merkelit, Volker Kauder postin e kreut të grupit parlamentar, vjen nga landi Renani Veriore-Vestfal. Pas tejkalimit të zgjedhjeve në dy lande, Merkelin e pret sfida tjetër politike. Kongresi i Partisë Kristiandemokrate, CDU në dhjetor. Merkel do të kandidojë sërish. Por kësaj here ka kundërkandidatë, tre politikanë, por politikanë nga radha e katërt. Koka të CDU-së, si Wolfgang Schäuble kanë bërë të ditur, se do të duan të kenë Merkelin si kryetaren e partisë. Pra, nuk mund të mos e vësh re se po punohet për epokën kan Merkelit. Por Merkel ende ka një bazë të fortë në presidiumin e CDU-së dhe mes ministrave konservatorë.

## TURQI/ KAMIONI ME EMIGRANTË BIE NË LUMË, 22 TË VDEKUR

Të paktën 22 persona, mes të cilëve edhe fëmijë, kanë vdekur pas një aksidenti automobilistik të ndodhur në Izmir, dhe njëmbëdhjetë të tjerë janë plagosur në provincën perëndimore turke. Lajmin e bën të ditur agjencia e shtypit 'Anadolu'. Sipas asaj që shkruhet në median turke të gjithë ishin emigrantë dhe udhëtonin brenda një kamioni të nisur nga Aydin drejt Izmirit, kur mjeti ka dalë nga rruga dhe ka përfunduar në një lumë. Shumë ambulanca janë dërguar në vendin e ngjarjes. Ende nuk dihet kombësia e emigrantëve. Një video e postuar në rrjetet sociale tregon kamionin në breg të lumit plotësisht i shkatërruar, me sende të ndryshme personale të shpërndara në zonë.





## Australi, çifti sulmohet dhe plagoset nga kanguri

Një grua është shtruar në spital me një mushkëri të dëmtuar, pasi është sulmuar nga një kangur në pronën e saj. Ngjarja ka ndodhur në qytezën e Millmerran, në jugperëndim të Queensland, në Australi, bën të ditur BBC. Edhe bashkëshorti i saj është plagosur duke marrë disa fraktura. Linda Smith, 64 vjeç dhe bashkëshorti Jim, po i jepnin

për të ngrënë disa kangurëve teksa njëri prej tyre, i lartë 1.82 metra, e ka sulmuar burrin që po përpiqej ta shlynte. Bashkëshortja dhe djali kanë ndërhyrë për ta mbrojtur, por kafsha ka sulmuar edhe gruan, duke e goditur me këmbë në fytyrë. Në këtë pikë, djali ka ndërhyrë me një lopatë dhe kanguri është larguar.



Uragani godet Portugalinë, Spanja nën alarm. Çfarë parashikohet të ndodhë


# "Leslie" stuhia më e rëndë që prej 1842

## 39 provinca në rrezik nga erërat me shpejtësi 190km/orë

Pasi është larguar nga ishujt Canarie, uragani Leslie, i klasifikuar si një stuhi tropikale, ka arritur brigjet e Portugalisë, me erëra deri në 190km/orë. Qyteti i parë i goditur ka qenë Figueira da Foz, rreth 200 kilometra në veri të Lisbonës dhe parashikohet, sipas Qendrës Kombëtare të Uraganeve të Shteteve të Bashkuara dhe agjencive meteorologjike spanjolle dhe portugeze, të spostohet gjatë ditës të djeshme drejt veri-lindjes të gadishullit iberik. Në Spanjë era do arrijë shpejtësinë deri 100km/orë dhe do të ketë shira intensive në 24 orët e ardhshme. Autoritetet kanë lëshuar alarmin e kuq dhe portokall në 39 provinca. Stuhia, më e rënda që godet Portugalinë që prej 1842, ka detyruar autoritetet të anulojnë 29 fluturime në nisje dhe mbërritje nga aeroporti i Lisbonës dhe Madeiras, dhe 12 të tjerë në atë të Oporto, bën me dije

### SPANJE

Në Spanjë era do arrijë shpejtësinë deri 100km/orë dhe do të ketë shira intensive në 24 orët e ardhshme. Autoritetet kanë lëshuar alarmin e kuq dhe portokall në 39 provinca. Stuhia, më e rënda që godet Portugalinë që prej 1842, ka detyruar autoritetet të anulojnë 29 fluturime në nisje dhe mbërritje nga aeroporti i Lisbonës dhe Madeiras, dhe 12 të tjerë në atë të Oporto, bën me dije agjencia Efe.



### PORTUGALI

Më shumë se 15 mijë banesa në Portugali kanë mbetur pa energji elektrike, në mënyrë të veçantë zona e Leiria, Setubal dhe rethinat e Lisbonës dhe kompania elektrike nuk përjashton që edhe zona të tjera do të përfshihen nga mungesa e energjisë, për shkak të uraganit Leslie, i klasifikuar si një stuhi tropikale.

me dije agjencia Efe. Më shumë se 15 mijë banesa në Portugali kanë mbetur pa energji elektrike, në mënyrë të veçantë zona e Leiria, Setubal dhe rethinat e Lisbonës dhe kompania elektrike nuk përjashton që edhe zona të tjera do të përfshihen

nga mungesa e energjisë, për shkak të uraganit Leslie, i klasifikuar si një stuhi tropikale. Mbrojtja civile ka ftuar banorët të qëndrojnë në shtëpi dhe vetëm në raste emergjence të dalin prej andej. Gjithashtu, banorët janë urdhëruar të qëndrojnë

larg brigjeve. Shumë pemë kanë rënë, zona të ndryshme janë përmbytur dhe qindra njerëz kanë kërkuar ndihmë në numrat e lëshuar nga autoritetet për ndihmë. Kjo situatë e paqëndrueshme dhe ekstreme është formuar në At-

lantikun qendror si një stuhi tropikale në 23 shtator dhe është forcuar si një uragan i kategorisë 1, për t'u shndërruar më pas në një stuhi, por është kthyer sërish në uragan në 11 tetor. Tani ai është klasifikuar sërish si një stuhi,

por trajektorja e tij është shumë e paqartë duke lëvizur tani me një shpejtësi të madhe. Edhe Mesdheu po përgatitet për të tjera stuhi. Rrezik të lartë dhe përmbytje parashikohen në Spanjë, Francë, Itali, Algjeri dhe Tunizi.

## I vendosën 25 emra, vajza 11-vjeçare s'i di të gjithë

Një vajzë ka 25 emra të mesëm dhe ende nuk i ka mësuar të gjithë. Mbani frymën, Willow-Sullivan Corbett Fitzsimmons Jefferies Hart Burns Johnson Willard Dempsey Tunney Schmeling Sharkey Carnera Baer Braddock Louis Charles Walcott Marciano Patterson Johansson Liston Clay Frazier Fareman Taylor-Brown. Nëna e 10-vjeçares Maria tha se kjo është një traditë familjare që u nis nga familja e saj në vitin 1974. 44-vjeçarja tha se familja i vendosi 25 emra. Të gjithë emrat e mesëm të 10-vjeçares janë emra fut-



bollistësh të famshëm. Gjyshi i Willow udhëtoi shumë jashtë vendit për të parë ndeshjet e boksit. Wil-

low Taylor-Brown, emri shkurt, mori emrat e çdo kampioni boksi të peshës së rëndë deri në vitin 1974.

## Panama/ Donte të bënte foto, gruaja bie nga kati i 27-të

Donte me shumë mundësi të bënte një selfie nga ballkoni me pamje nga Panamaja, kur ka humbur ekuilibrin dhe ka rënë nga kati i 27. Viktima është një vajzë portugeze. Aksidenti fatal, i filmuar me video ka bërë xhiro në web dhe ka ndodhur në një rezidencë të Cangrejo. Lajmin e tragjedisë e kanë dhënë shërbimet e sigurisë panameze që kanë dhënë një mesazh sensibilizues: 'Mos rrezikoni jetën për një selfie. Është më e rëndësishme të humbësh një minutë në jetë, se sa të gjithë jetën në një minutë'.



Opiniononi **i** Ditës

# Maqedoni: Të rinjtë pa shpresë për punësim

Nga Zërijeta Hajro Jajaga

(vlijon nga faqja 1)

...është ajo që i dëbon të rinjtë jashtë vendit.

Ekspertët thonë se nëse vazhdon edhe më tej trendi largimit të të rinjve, Maqedonia si shtet shumë shpejt do të përballlet me problemin e mungesës së kuadrit të kualifikuar.

"Vendi po zbrazet nga zejtarë të profileve të ndryshme. Tani është bërë e vështirë të gjeni një mjeshtër të mirë, në më shumë profile ata mungojnë. Ata brenda tre muajve sa mund të kenë leje qëndrimi arrijnë të sigurojnë të ardhura shumë më shumë sesa është lartësia e pagës në nivel vjetor këtu", thotë Petar Gooshev, ish-Governator i Bakës Popullore të Maqedonisë.

Nga ana tjetër, ministria e Punës dhe Politikës Sociale Milla Carovska, në një intervistë për Radion Evropë e Lirë thotë që qeveria e Maqedonisë përmes programit "Garancia e të rinjve, e cila zbatohet edhe në vendet e Bashkimit Evropian", vetëm gjatë vitit të fundit ka përfshirë 2 mijë të rinj prej të cilëve 600 kanë arritur të punësohen.

Por, Zoran Ilievski nga koalicioni i të rinjve "Sega" thekson se për t'u ndaluar trendi i largimit të të rinjve nga vendi, veçanërisht ata që janë në profilet deficitarë, nevojitet me urgjencë të përmirësohet cilësia e arsimit si dhe të punohet në rritjen e pagave.

"Me patjetër duhet fokusuar



veçanërisht në ngritjen e cilësisë së arsimit në shkollat profesionale. Çka do të thotë kjo? Do të thotë se të rinjtë me dijen e fituar duhet të jenë konkurrues në

tregun e punës, por në këtë treg pune duhet të sigurojnë të ardhura për një jetë dinjitoze", thotë Ilievski.

Nga ana tjetër, Arlinda Baftiu, ak-

tiviste për të drejtat e të rinjve, për Radion Evropë e Lirë thotë se ambienti politik aktual ka shuar dhe shkëndijat e vogla të cilat, siç thotë, dukeshin në

horizont me aktivitetet e fundit të qeverisë.

"Ambienti aktual politik, bën që ata të jenë të dëshpëruar për situatën politike në të cilën ndodhet vendi. Tani kjo krizë edhe më shumë i ngufat shpresat për të ndërtuar të ardhmen këtu, sepse për vite me radhë ata përballen me të njëjtat probleme".

"Tani jemi në një situatë politike akoma më kritike sidomos pas dështimit të referendumit, dhe mendoj kjo do të bëjë që të rritet edhe më shumë fluksi i largimit të të rinjve nga vendi, për shkak të krizës në të cilën ndodhet vendi dhe dëshpërimit nga mos zgjidhja e problemeve të shumta me të cilat përballen të rinjtë për vite", thotë Baftiu. Ndryshe, sipas të dhënave të Entit shtetëror të statistikave në vitin 2017, për punë nga mosha 15 deri në moshën 35 vjeçare janë paraqitur mbi 114 mijë qytetarë që përbën mbi 50 për qind të numrit të përgjithshëm të personave që kërkojnë punë në Maqedoni.

Këto të dhëna tregojnë se qeveria duhet me seriozitet t'i qaset problemit të papunësisë të grupmoshat e reja, thonë ekspertët në këtë lëmi.

ndodh në të gjitha vendet ku arsimi ecën përpara. Dhe për prindërit të bëjnë kujdes në zgjedhje!

**THASHETHEME MADE IN ALBANIA**

## Te gjitha te rejat nga jeta ipave

V

çdo të shtunë falas me

**GAZETA SHQIPTARE**

Opinion *i* Ditës

# Një komb në rrezik


Nga Dr. Valbona Nathanailli

(vijon nga faja 1)

...York-ut (ShBA), për futjen në agjendën e diskutimeve në shkencën e ekonomisë të dy çështjeve që kanë qenë objekt shqetësimi për një kohë të gjatë për shoqërinë, ndryshimet klimaterike dhe inovacioni në fushën e teknologjisë. Shkurt, deri dje, kemi paguar karburantin dhe komoditetin e lëvizjes me makinë, por jo çmimin e ndotjes së atmosferës; kemi paguar gjithnjë më pak për teknologjinë e re dhe jemi kënaqur që kompjuterët shiten më lirë, por nuk na ka interesuar se bashkë me çmimin, është zhvlerësuar edhe gjenerata e dijes. Nëse vëmë përballë ekonomistët e tregut të lirë me aktivistët për mbrojtjen e interesave të publikut, të parët, në përgjithësi, llogarisin dhe promovojnë vetëm kostot e drejtpërdrejta të mallit; grupi i dytë interesohet edhe për kostot që prodhimi e qarkullimi i këtij malli ka në natyrë a shoqëri. Arritja është kur mbrojtja e interesave të publikut vjen nga radhët e vetë ekonomistëve, ose nga brenda.

Në këtë mjedis tejet konservativ, dy amerikanët patën kurajën, vizionin e largpamësinë të identifikojnë dhe llogarisin dëmin që i bëhet shoqërisë nga djegia e karburantit në mënyrë të pakontrolluar dhe zhvlerësimi i dijes, duke ndërhyrë me variabla të rinj dhe krijuar modele matematikore që e shndërrojnë në vlerë këtë dëm. Studimet u shndërruan në apel për qeveritë për të mos bërë sehir. Dhe falë gjetjeve të tyre, sot pothuaj të gjithë shtetet kanë vendosur taksonë e ndikimit negativ në përbërjen e atmosferës nga djegia e karburanteve (e njohur si taksa e karbonit), ndërkohë që janë ndërgjegjësuar për investimet e vazhdueshme që duhen bërë për të mbështetur e nxitur shkencën e teknologjinë.

Gjuha vete ku dhëmb dhëmb! Duke referuar përsëri tregun dhe mosfunksionimin e tij në mënyrë ideale në segmente të caktuara, që do të thotë nevojën që kemi si shoqëri për të korrigjuar mekanizma të caktuar të modelit fillestar (template) të tregut, përpas sa më sipër, mund të ngrihet edhe një shqetësim tjetër, në fakt, i vjetër për vendet e tjera, por jo për vendin tonë: A funksionon idealisht tregu i lirë edhe në sektorin e arsimit? Thënë ndryshe, kur blejmë shërbimin që ofron një universitet a një shkollë, domethënë arsimimin nga çasti i regjistrimit deri në atë të pajisjes me diplomë, çmimi që paguajmë mbulon të gjitha kostot që llogarisin zakonisht ekonomistët, duke filluar nga amortizimi i ndërtesës ku bëhet mësim, pagat e pedagogëve dhe shumë të tjera. Në mënyrë ideale, çmimi mbulon kostot që referon vetëm shërbimet që ofrohen nga çasti i regjistrimit deri në atë të diplomimit, pra kënaqin individin për çfarë ka paguar. Çmimi nuk merr në konsideratë kostot që duhet të paguajnë brezat e ardhshëm nga furnizimi me këta të diplomuar, të cilët do të hartojnë politika e marrin vendime edhe në emër të tyre. Kjo kosto ekstra quhet eksternalitet dhe në rastin e shkollës, në përgjithësi, duhet të jetë pozitive: me supozimin që uni-



versiteti ka qenë cilësor dhe të diplomuarit ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e vendit. Që kjo kosto të mos jetë negative, pra që të diplomuarit të mos "ndotin" atmosferën tonë sociale dhe të dëmtojnë zhvillimin e progresin e vendit në dhjetëra vitet në vijim, na duhet një ent rregullator që jo vetëm të certifikojë cilësinë e këtij shërbimi, por edhe të ofrojë informacion për studentët se çfarë ndodh në këto shkolla. Në vitin 1983, Këshilli Kombëtar për Ekselencën në Arsimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, hartoi një raport me titull "Një komb në rrezik". Raporti përshkruante standardet e ulëta në performancën e nxënësve amerikanë, ndërkohë që vetë kurrikulën e cilësonte si një menu kafeneje, ku antipasta dhe ëmbëlsira mund të merren lehtë si pjata kryesore dhe, vetë mësuësit, si të papërgatitur. Raporti kërkonte ndryshime në përmbajtjen akademike, duke e cilësuar si mediokre apo edhe katastrofë për sistemin amerikan, si dhe rritjen e pritshmërive për cilësinë e sasive e dijes dhe të mësimdhënies. A jemi edhe ne "Një komb në rrezik"? Për të arritur në një konkluzion të tillë, na duhen raporte të kësaj natyre, që, në fakt, mungojnë, por kemi arsye të shqetësueshme se menuja që ofrohet është jo vetëm e tipit "kafë", por edhe

vetë kafeja shpesh nuk është as kafe, por lëng gështenjas. Për ilustrim dhe në vijim të argumentit shtruar më sipër, po marr shembullin e një programi edukimi që ofrojnë dy universitetet të ndryshme që përgatisin mësues. Në Universitetin publik të Tiranës, për t'u diplomuar "Mësues për arsimin e mesëm", një student ndjek një program Bachelor tre vjeçar në një degë të caktuar dhe, më pas, edhe një Master Profesional dy vjeçar, ku integrohen njohuri nga pedagogjia me njohuri në të thelluar në disiplinën përkatëse. Në përfundim, titulli është "Mësues për arsimin e mesëm në lëndën... (të themi gjeografi)". Një diplomë të ngjashme ofrojnë edhe disa universitetet private, por tashmë me emërtimin e reduktuar "Mësues për arsimin e mesëm" (?) dhe në përfundim të ndjekjes së një Masteri Shkencor. Po t'i kthehemi edhe një herë programit të studimit që ofron Universiteti i Tiranës, Masteri Shkencor të themi në gjeografi, të orienton drejt një fushe krejtësisht të ndryshme nga ajo e mësimdhënies. Edhe një ilustrim tjetër: Falë interpretimit të gabuar që i bëhet ligjit për arsimin e lartë, ekziston ideja se Masteri është shkalla që të ngjitet më lart. Për shembull, nëse mbaron studimet Bachelor për Arsimin Fillor, përfundimi i studimeve Master të shndërron Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët.

Në kushte të tilla, studentët-klientë, në mungesë të informacionit, mund të blejnë një produkt i cili në terma afat-gjatë rezultojnë në kosto negative jo vetëm për shoqërinë, por edhe për ata vetë, reflektuar, për shembull, në numrin e madh të të diplomuarve që mbesin në provimin e shtetit kur kërkojnë të fillojnë punë në profesion. Në kontekstin e teorisë ekonomike, në rastin e këtyre dy programeve krejtësisht të ndryshëm, tregu quhet i dështuar jo vetëm për shkak të vlerës negative të eksternalitetit që mbart produkti i prodhuar (lexo studentit të diplomuar) dhe nëpërmjet së cilës deformon shoqërinë, por edhe të diferencave të theksuara të të njëjtit produkt ofruar nga shitës të ndryshëm (lexo mësues të arsimit të mesëm diplomuar nga universitetet të ndryshme). Kufizimet e tregut të lirë, veçanërisht kur kemi të bëjmë me sfida që kërkojnë zgjidhje në terma kohorë afat-gjatë, njihen prej një kohe të shumë të gjatë. Por që këto kufizime të mos kthehen në kosto me efekt negativ, duhet reaguar. Apeli këtu është për forcimin e rolit rregullator të agjencive të licencuara, sikundër ndodh në të gjitha vendet ku arsimi ecën përpara. Dhe për prindërit të bëjnë kujdes në zgjedhje!

**HOROSKOPI**

---

**DASHI**

Personat e kësaj shenje që vuajnë nga tensioni duhet të tregohen shumë të kujdesshëm sot. Do të finalizoni një marrëveshje financiare, e cila do t'ju sjellë mjaft të ardhura ekonomike. Sa i përket jetës martesore, do të jetë një ndër ditët tuaja më të lumtura.

---

**DEMI**

Do ta keni të vështirë të përqendrohëni në punë, për shkak të disa problemeve familjare. Duhet të mendoheni mirë para se të investoni para në një skemë që do t'ju prezantohet sot. Romanca do t'ju pushtojë sot gjatë një takimi me gjysmën e zemrës suaj në mbrëmje.

---

**BINJAKET**

Aktiviteti e sotme do të jenë të lodhshme dhe stresuese. Tregohuni të heshtur për qëllimet në jetën. Ka gjasa që partneri/partnerja juaj të jetë i irrituar sot, çfarë do të shtojë presionin në mendjen tuaj. Aftësia juaj për të vepruar me shkathtësi në punë do të vlerësohet sot.

---

**GAFORJA**

Ushtrimet fizike do t'ju bëjnë të ndiheni shumë energjikë gjatë ditës. Përdorini idetë tuaja inovative për të fituar më shumë para. Tregohu i sjellshtëm dhe bëj kujdes me fjalët, pasi mund të bëhen shkak për t'u përballur me një konflikt.

---

**LUANI**

Përfshihuni në aktivitet që ju qetësojnë dhe iu bëjnë të ndiheni mirë. Do të keni probleme me paratë sot. Ka gjasa të shpenzoni më shumë seç e kishit parashikuar. Ndoshta mund të zhgënjeheni në dashuri, por mos u shqetësoni pasi mund t'ju kontaktojë dikush nga e kaluara.

---

**VIRGJERESHA**

Sot do të ndiheni të relaksuar dhe do të keni dëshirë të argëtoheni dhe të kënaqeni pafund. Bëni kujdes pasi mund të përfshihen në një debat në familje. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat.

---

**PESHORJA**

Problemet në shtëpinë tuaj do të jenë në rritje, ndaj bëni kujdes me ato çfarë thoni dhe tregohuni më të arsyeshëm. Do të keni dëshirë të realizoni shumë gjëra, por për shkak të irritimit që do të ndjeni, ka gjasa të mos arrini objektivat tuaja.

---

**AKREPI**

Problemet e një mikut tuaj do t'ju bëjnë të ndiheni të mërzitur dhe të shqetësuar. Do të kaloni një mbrëmje të shkëlqyer me partnerin/partneren tuaj. Ka gjasa të befasoheni nga një surprizë, e cila do t'ju kënaqë pamashë.

---

**SHIGJETARI**

Ruaj durimin pasi përpjekjet tuaja të vazhdueshme do të sigurojnë sukses. Ka gjasa që për shkak të agjendës suaj të ngarkuar të shfrytëzoni të parashikuar disa kohë më parë. Mund të zhgënjeheni në dashuri, po kjo nuk do t'ju dekurajojë aspak.

---

**BRICJAPI**

Pritshmëritë e larta mund t'ju rezultojnë në zhgënjim. Një i njohur nga e kaluara mund të bëhet shkak për mosmarrëveshje me partnerin/partneren tuaj. Sa i përket anës ekonomike, nuk do të jetë dita e duhur pasi do të paguani disa fatë të prapambetura.

---

**UJORI**

Sot do ta shijoni maksimalisht kohën e lirë. Shmangni personat që iu afrohen për interes apo për të kërkuar hua të përkohshme. Do të ndiheni mirë pranë miqve tuaj të ngushtë.

---

**PESHQIT**

Kushitjoni më shumë kohë vetes suaj sidomos aktiviteti fizik. Miqtë dhe familja ju zënë pjesën më të madhe të kohës. Gjendja juaj financiare do të përmirësohet teksa do t'ju shlyejnë disa borxhe të marra kohë më parë.



Trajneri e cilësoi ndeshjen si të jashtëzakonshme

Panuçi: Tani jemi jashtë, më vjen keq për djemtë

Trajneri i përfaqësues shqiptare, Kristian Panuçi, e ka cilësuar të jashtëzakonshme ndeshjen e djeshme, por ka pranuar se tashmë shanset e kuqezinjve ishin thuhajse zero për të vazhduar më tek. "Më vjen shumë

keq për djemtë, se kanë bërë një ndeshje të jashtëzakonshme, kemi bërë lojë. Kemi pësuar gol me një rivënie të portierit dhe kjo është shumë e rëndë. Ndërsa të dytin e kemi pësuar me një autogol, por të kthehesh në

shtëpi me një 0-2 të luajtur kështu të bën të ndjehesh shumë keq", tha ai për RTSH. "Goli i parë? Unë u ktheva, pashë topin që po shkonte të Hemed dhe pastaj pashë përsëritjen. Kemi fjetur, thjesht kemi fje-

tur. Është e vështirë tani se duhet të fitosh 3-0 dhe të shpresosh që Skocia të mundë Izraelin, pastaj me pikë jemi të barabarta do të ishim me golavarazh keq. Jemi jashtë, nuk jam dorëzuar, por bëhet e vështirë. Është mëkat, se kemi bërë një ndeshje me shumë cilësi. Nuk më pëlqen që thoni emra, ishte një skuadër e madhe që ka bërë një ndeshje të madhe dhe nuk më pëlqen të përmend emra", tha Panuçi.

Shqipëria bën lojën më të mirë me në krye ish-romanistin, por as kjo nuk mjaftoi për të marrë një pikë

Jeton Selimi


# Izraeli bën për ujë të ftohtë kuqezinjtë e Panuçit

## 2-0 në Ber Sheva, shënojnë Harush dhe Saba

Izraeli fiton dhe praktikisht gëpëson vendin e Shqipërisë për vendin e parë në grup, duke e përmbysur situatën nga pretendimi i madh në frikën e madhe, atë të rënies në një grup më posthtë. Në Beer Sheva, kuqezinjtë luajnë dhe krijojnë raste të mira për shënimi, por asnjëherë nuk do ta fusin topin në rrjetë. Nga ana tjetër Izraeli shënon me lehtësi në dy nga rastet e tij, duke arkivuar një fitore që i jep vendin e parë në grup dhe që e çon të qetë në Skoci.

Në Ber Sheva Mavraj e Gjimshtiti do të krijojnë dyshen e qendrës me Hysajn e Binakun që veprojnë në krah. Në mesfushë rikthehet Basha e Memushaj, që së bashku me Xhakën ndihmojnë sulmin e formuar nga Grezda, Uzuni dhe Balaj.

Shqipëria do të krijojë momentin e parë të mirë, kur nga zhvillimet e një këndoreje, Balaj do të godasë me kokë, por Harush do të bëjë mrekullinë. Madje portieri nuk do të ndalet me kaq, pasi pak sekonda më vonë do të japë asistin për Harush, një top prej 70 metrash që sulmuesi e depoziton në rrjetë, duke parë dhe daljen aventureske të Strakoshës. Minuta e 8-të dhe vendësi në avantazh, ndërsa kuqezinjtë vuanë golin e pësuar, pasi rasti i radhës për tanët do të vijë në të 22-ën, kur Harush largon në goditje këndi topin duke i hequr mundësinë e barazimit Grezdes dhe Uzunit. Në minutën e 37-të gardiani izraelit do të bëjë një pritje të dyfishtë, fillimisht në gjuajtjen e Xhakës dhe pastaj në goditjen me kokë të Gjimshtitit. Me fillimin e pjesës së dytë Izraeli mund të kishte dyfishuar pas gafës së Mavrajt, por Dabur gabon. Shqipëria provon të rrisë lojën dhe ia del, por ai që do të çalojë është finalizimi dhe krijimi i rasteve ideale të shënimit. Por atë që nuk do ta bëjnë kuqezinjtë do ta bëjnë të zotë e shtëpisë kur Saba nga jashtë zone kalibron të djathtë, që fillimisht gjen shtyllën e më pas tund rrjetën e Strakohësh. 2-0 dhe Shqipëria kapitulon sërish në transfertë, duke kompromentuar mbase përfundimisht shanset e saj për vendin e parë në grup.



### Flet sulmuesi Balaj: Nuk mjaftoi ajo që krijuam, dhemb mënyra sesi pësua golin

Bekim Balaj ju afrua disa herë golit në takimin ndaj Izraelit, por pa arritur të shënojë. Në një prononcim për "Supersport", ai u shpreh se ekipi luajti mirë dhe ishte i qetë në fushë. "Të dhemb mënyra si pësua golin e parë por gjatë gjithë ndeshjes treguam karakter dhe kërkuam golin. Ndikoi dhe fakti që gjatë gjithë ndeshjes nuk po shënonim dot. Më pas Izraeli shënoi dhe golin e dytë e kjo i dha fund. Në pjesën e parë ruajtëm qetësinë, por na e vështirësoi lojën që nuk shënuam dhe prandaj humbëm. Duhet të provonim më shumë dhe nga qendra. Shpresonim të paktën një barazim, por nuk patëm fat. Janë zgjedhje të trajnerit ndërrimet. Nuk ka rëndësi si luanim, me dy apo me 5 sulmuesia", u shpreh Balaj.

#### KOMBINIMET

Ja si mund të kualifikohet Shqipëria Shqipëria mbetet në kuotën e 3 pikëve në grup, ndërsa Izraeli mban vendin e parë me 6 pikë, ndërsa Skocia qëndron sipër nesh, edhe pse ka 3 pikë, falë golavarazhit. Me këtë rënditje aktuale, duhet një kombinim i frikshëm, për të shpresuar kualifikim nga vendi i parë.

Në ndeshjen e fundit në Shqipëri ndaj Skocisë, duhet një fitore 3-0, dhe golavarazhi i Shqipërisë do të shkonte zero, ndërsa do të linim pas Skocinë. Ndërkohë, në ndeshjen tjetër mes Skocisë dhe Izraelit, Shqipëria do duhej të priste humbjen 1-0 të Izraelit.

#### SHKURTE

##### Liga e Kombeve, Italia gjen fitoren në ndeshjen e tretë

Në ndeshjen e tretë të Ligës së Kombeve, një Itali që bëri një futboll të bukur mundi me meritë Poloninë me rezultatin 1-0 dhe shkon në Ligën B. Për të kaltritur pjesa e dytë ka qenë mrekullueshme, ndërsa Zhorzhinjo e Insinje goditën traversën. Ndërkohë që portieri i polakëve Shezani u impenjua nga tentativat e Zhorzhinjos, Kielinit dhe Florencit. Në pjesën e dytë, ndeshja ishte më e ekuilibruar dhe u vendos nga një prekje e topit në minutën e 92' nga Biraghi. Sfida e radhës do të jetë më 17 nëntor në Milano kundër Portugalisë.


##### Miqësorja/ Portugalia i jep leksion Skocisë

Skocia nuk po kalon aktualisht një moment të mirë dhe kjo shihet qartë nga rezultatet që ka regjistruar së fundmi skuadra e drejtuar nga Aleks MekLish. Ky i fundit rrezikon seriozisht të mos mbyllë edicionin dhe për mediat në vendin e tij, shkarkimi është një opsion më se i mundshëm nëse nuk mund Shqipërinë në nëntor në Shkodër. Ky mendim është shtuar pas duellit të sotëm, ku Skocia mori një leksion të mrriz futbollit edhe nga Portugalia, e cila kishte lënë pushim disa nga yjet e saj. Për portugezët, gjithçka u bë e lehtë që në pjesën e parë, kur Helder Kosta shënoi golin e avantazhit pasi për shumë minuta skocezët ishin shfaqur pa ide dhe nuk dukej se mund të thimbonin Kamponët e Europës në fuqi. Heroi i Europianit, Eder, realizoi golin e dytë pas pushimit të ndeshjes, ndërsa Bruma realizoi të tretin pak minuta para fundit. Goli i Neismith në shtesë ishte ngushëllim i vogël për skocezët, të cilët duket se janë shpërbërë thuhajse plotësisht pas asaj humbje në Izrael.

##### Trajneri i Sittit Pep Guardiola: Ekipi që më pëlqen më shumë në Serinë A është Sasuolo

Trajneri i Manchester Sittit dhe një nga trajnerët më të mirë në botë, Pep Guardiola ka habitur të gjithë me intervistën e tij në "Sports Festival", ku ka folur më shumë për futbollin italian. "Dëgjova Ancelotin që i thuri elozhe skuadrës së Sasulos dhe jam shumë dakord me të. Ajo është një skuadër shumë e mirë dhe shembull për të gjitha skuadrat e tjera të vogla. Sasuolo nuk është një ekip që mbrohet dhe luan me kundërsulme, nuk është as ekip që luan për një pikë. Kjo filozofi më pëlqen shumë dhe po, ata janë një nga skuadrat e mia të preferuara në Serie A", u shpreh Guardiola.

### Fjalëkryqi (1)



**HORIZONTAL**

1. Ishte dekret i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Është bosh.
10. Është studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitim.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbijqajt Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoërn.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Është për medaljen e parë
34. Janë nofka.

38. Satelit i Jupiterit.
39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstre me sirtar.
45. Kështu shtë lojtari i under 21.
47. Është gjuajtja personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.

**VERTIKAL**

1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë temperuraturat më të ulëta.
5. Inicialet e Lendit.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisore.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishte gjuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihet kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorezë.
21. Është periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjissor.
37. Parajsa e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.


### Fjalëkryqi (2)

**HORIZONTAL**


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Është skllavëri.
16. Është shtypji po përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Është ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marifete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuesit.
32. Skuadra merengue.

**VERTIKAL**


33. Është trofet që fitohet.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshe.
39. Qetësonte detin.
42. Kanë dhoma që zihen.
44. Është ekulibri në palestër.
46. Në krye të jurisë.
47. Numri i kuartetit.
48. Gjysmë armate.
9. Është edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Është i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Është besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë thörn.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazil.
34. Është copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëllhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.



### Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

### SUDOKU

1			6	8		7
						2
8		9		1	5	3
	9			5	2	
3	4					5
	5	6	8			9
	7					8
						9
			2			9
						4
						2

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	2	4	9	5	6	7	1	8
5	7	6	1	4	8	2	9	3
8	9	1	2	3	7	4	5	6
4	6	2	7	1	3	9	8	5
9	5	7	8	6	2	3	4	1
1	3	8	4	9	5	6	7	2
2	8	5	3	7	9	1	6	4
6	1	9	5	2	4	8	3	7
7	4	3	6	8	1	5	2	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

### Argëtim filozofik

- Mendimet e larta gjenden në fjalë të shkurtra.
- Më e bukura fjalë është e thjeshtë dhe e shkurtër, është fjalë që kuptohet më lehtësi dhe që ka kuptim të thellë e të hollë.
- Njeriun e bëjnë të përditshëm veprat e tij.
- Detyrat janë kryesore ndaj njerëzisë është të studiojë dhe të mësojë (të tjerët) pa u merrtur.

### KRIPTOSKEME

8	4	1	2	3	4	6	5	3	4	1	4
1	2	8	1	5	8	4	7	10	6	4	3
10	6	7	2	7	11	6	2	1	4		
10	7	15	1	12	1	2	3	4	10	1	
1	12	1	4	3	2	6	4	3	1	2	
4	2	6	11	3	2	6	4	3	1	14	3
1	2	4	16	2	7	16	6	18	1	4	4
	1	2	5	3	14		3	1		1	
1	19	1		4		11	3	4	2	6	15
8	1	5	4		18	6	2	1	4	3	6
5	16	1	10	6	4	3	4	6		3	18
10	3		15	3	18	6		14	5	14	1

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

H	I	J	A	K	S	S	T	O	L		
A	N	E	T	D	A	F	H	L	T		
B	A	T	H	E	R	E	T	I	K	E	
I	T	H	O	N	O	R	A	R	I	T	
T	K	A	P	I	T	A	L	I	S	T	E
O	A	L	K	R	A	T	R	L			
R	E	A	I	O	S	J	I	A	E		
E	S	N	A	T	O	T	I	F			
M	I	S	S	P	O	E	T	N	O		
N	I	K	I	M	L	A	M	E	N		
A	N	E	S	T	E	Z	I	S	T	R	A
T	A	B	A	R	A	K	A	I	T		

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

L	U	I	S	A	K	O	H	A	A	D
P	O	R	T	A	F	A	T	A	L	E
E	S	A	D	L	P	R	A	N	I	S
N	A	T	P	E	L	I	K	A	N	I
E	L	S	A	B	O	T	I	M	E	T
L	A	K	O	N	I	K	E	T	V	T
M	O	N	O	T	O	N	V	E	T	E
B	O	L	E	R	O	I	B	E	R	I
P	S	T	I	A	R	I	R	R	I	P
I	K	E	N	O	T	A	N	A	D	A
N	K	E	A	T	A	N	A	D	A	
R	O	W	A	N	B	A	R	A	L	L
A	B	E	L	P	N	A	T	A	L	E
S	O	E	P	I	E	T	I	T	R	I
A	K	R	A	T	R	I	T	A	T	O
K	E	H	F	A	M	A	R	E	K	A
K	E	H	F	A	M	A	R	E	K	A
K	O	L	O	N	A	K	T	E	C	E
T	I	N	E	L	E	T	R	E	R	O
E	R	A	I	T	K	E	S	T	I	A
T	A	T	K	A	R	A	H	E	P	
E	T	J	A	K	A	T	E	T	E	T

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

### Thënie të mençura

- I madh është ai njeri që i shikon të gjithë një soj, që vepron pa anuar, dhe që mendon për të gjithë.
- Ai që mendon për interesat e veta, është njeri i ulët.
- Detyrat janë kryesore janë një barrë e rëndë; sjellja e keqe sipas andjes dhe pëllqimit të botës është një moçal i madh. Për të
- nxjerrë në breg një barrë të tillë të rëndë
- nga një moçal i tillë, duhet të ecësh drejt, pa shikuar djathtas e majtas.
- Në vend që të shesësh dituri dhe zotësi, përpiqu t'i fitosh ato.

